Dr. MAJLINDA ZIU

# LIBËR PËR MËSUESIN
# Gjeografia 6

BOTIME

pegi

# Mësues të dashur!

Ky libër mësuesi, ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron. Udhëzimet e tij bazohen në programin e IZHA-s, miratuar nga MAS-i. Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor dhe fletorja e punës së nxënësit, janë hartuar në frymën e të nxënit me kompentenca. Ju do t'i orientoni nxënësit drejt krijimit të kompetencave, punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 3-mujore dhe ditore. Ju mund t'i përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat dhe nivelin e nxënësve.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

**Ju urojmë punë të mbarë!**

# Përmbajtje

I. Çfarë na orienton dhe kërkon programi i gjeografisë? ....... 5
I.1. ***Qëllimet e programit*** ....... ***5***
I.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës ....... 6
I.3. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj ....... 10
I.5. Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi gjatë procesit të të nxënit: ....... 11
I.6. Çfarë situatash duhet të përdoren në funksion të të nxënit? ....... 12
I.7. Në sa mënyra vlerëson mësuesi/ja? ....... 12

II. Modele të planifikimit vjetor, 3-mujor dhe ditor të mësuesit/es. ....... 14
II.1. Modeli i planifikimit vjetor ....... 14
II.2 Modeli i planifikimit mujor (me disa situata model) ....... 16

PLANI 3-MUJOR (JANAR-MARS -12 orë); KLASA VI ....... 29
PLANI 3-MUJOR (PRILL – QERSHOR 10 orë); KLASA VI ....... 37
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (modele skematike) ....... 43

Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik ....... 44
Tema mësimore: I.1 Gjeografia dhe roli i saj ....... 44
Tema mësimore: I.2 Disa periudha të rëndësishme të zhvillimit të njohurive gjeografike ....... 46
Tema mësimore: I.3 Degët e gjeografisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera ....... 48
Tema mësimore: I.4 Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik ....... 51
Tema mësimore: I.5 Pesë temat bazë të gjeografisë ....... 53
Tema mësimore: I.6 Rajoni ....... 55
Tema mësimore: I.7 Lëvizja ....... 57
Tema mësimore: I.8 Bashkëveprimi njeri-natyrë ....... 59
Përsëritje 1 (model). Tema: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik ....... 61

Nëntematika II: Hartat gjeografike ....... 62
Tema mësimore: 2.1 Paraqitja grafike e Tokës ....... 62
Tema mësimore: 2.2 Përmbajtja e hartës ....... 64
Tema mësimore: 2.3 Rrjeta gjeografike ....... 66
Tema mësimore: 2.4 Koordinatat gjeografike ....... 68
Tema mësimore: 2.5 Shkalla e hartës ....... 70
Tema mësimore: 2.6 Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre ....... 72
Përsëritje 2 (model). Tema: Hartat gjeografike ....... 74

Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal ....... 75
Tema mësimore: 3.1 Vendndodhja gjeografike e vendbanimit tonë . ....... 76
Tema mësimore: 3.2 Tiparet e relievit në vendbanimin tonë ....... 78
Tema mësimore: 3.3 Pasuria ujore në vendbanimin tonë ....... 80
Tema mësimore: 3.4 Klima dhe bota e gjallë në vendbanimin tonë ....... 82
Tema mësimore: 3.5 Popullsia në vendbanimin tonë ....... 85
Tema mësimore: 3.6 Lloji i vendbanimit dhe aktivitetet prodhuese të tij ....... 88
Tema mësimore: 3.7 Trashëgimia natyrore dhe kulturore e vendbanimit tonë ....... 91
Tema mësimore: 3.8 Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedisin natyror të vendbanimit tonë. ....... 93

# I. Çfarë na orienton dhe kërkon programi i gjeografisë?[1]

()

## I.1. *Qëllimet e programit*

***Programi i gjeografisë për shkallën e 3-të synon që nxënësi/ja:***

- ***Të zhvillojë kuriozitetin për vendet, njerëzit, kulturat dhe mjediset në botë;***
- ***Të zhvillojë dijet për dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike mbi bazën e një përgatitjeje të përshkallëzuar dhe ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues.***
- ***Të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, vendet e tjera, njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë.***
- ***Të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik.***
- ***Të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.***
- ***Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.***

1 Kjo çështje është trajtuar bazuar në programin e hartuar nga IZHA, viti 2014

**Korniza konceptuale e programit (sipas programit të hartuar nga IZHA, viti 2014)**




# I.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës / lëndës

Mësuesi/ja duhet të mbajë parasysh lidhjen e ***kompetencave kyçe me kompetencat e fushës***. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi/ja duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme që i shërbejnë procesit të të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies***.

- **Kompetenca qytetare**

Si pjesë e fushës "Shoqëria dhe mjedisi", përmes kërkimit gjeografik, programi i gjeografisë krijon kushte për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi/ja të kompetencës qytetare. Në shkallën e tretë, nxënësi/ja hulumton për çështje aktuale gjeografike. Ai/ajo vlerëson gjetjet e tij/saj në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore në nivel lokal e global, diversitetin dhe respektimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në zonën ku jeton etj.

Përmes eksplorimit të çështjeve të tilla, nxënësi/ja nxitet të mendojë në mënyrë kritike, të marrë vendime dhe të veprojë për adresimin e çështjeve qytetare në një botë të ndërvarur dhe diverse. Nxënësi/ja propozon rrugë alternative për sfida apo çështje të ndryshme gjeografike, duke marrë në konsideratë faktorët mjedisorë, ekonomikë dhe shoqërorë.

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

Programi krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi/ja përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai/ajo mëson si të vlerësojë këto burime dhe të kuptojë se si mund të përdoret gjuha për të manipuluar të nxënin. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve apo prezantimeve zhvillon shkathtësi të të shprehurit; zhvillon në mënyrë progresive edhe fjalorin gjeografik, për komunikimin e informacionit dhe të ideve në audienca të ndryshme.

- **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi/ja zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai/ajo zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi/ja të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren. Nxënësi/ja nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese për mënyrat e përdorimit sa më racional të burimeve natyrore. Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematike për ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, si shkalla, largësia, koordinatat.

- **Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur kërkimin gjeografik, nxënësi/ja përdor metoda efektive të punës, shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai/ajo përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij/saj dhe komunikimin e gjetjeve. Nxënësi/ja mendon në mënyrë kritike kur konsideron pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjen e problemeve globale, kur pozicionohet dhe mbron qëndrimin e tij/saj.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin/en të njohë kulturën e tij/saj dhe kulturat e tjera. Ai/ajo mëson ku është dhe si lidhet me të tjerët pozita e tij/saj. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstron respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimin ndryshe. Përdor gjuhën e gjeografisë për të shprehur mendimet dhe idetë e tij/saj dhe për të organizuar përgjigjet.

- **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elemente të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin/en të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësit/et mësojnë të bashkëpunojnë ndërsa përballen me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

- **Kompetenca personale**

Programi i gjeografisë stimulon të nxënin bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve/eve për të menaxhuar veten. Nxënësit/et kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në grup, në klasë dhe në terren, nxënësit/et zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

- **Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë gjeografike, për vendin e tij/saj, marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

| Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë<br>SHKALLA 3 |
|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit** *(nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)* |
| • Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>• Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim. |
| **Kompetenca e të menduarit** *(nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)* |
| • Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media.<br>• Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.<br>• Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.<br>• Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.<br>• Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme, nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.<br>• Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy dhe më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore. |
| **Kompetenca e të nxënit** *(nxënësi/ja mëson për të nxënë)* |
| • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.<br>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë,veprim,aktivitet ose detyrë që i kërkohet.<br>• Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.<br>• Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur ) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. |

| |
|---|
| • Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren). |
| **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin *(nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)*** |
| • Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror, me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.<br>• Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). |
| **Kompetenca personale *(nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)*** |
| • Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup. |
| **Kompetenca qytetare *(nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)*** |
| • Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.<br>• Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura e që jetojnë në bashkësinë e gjerë. |
| **Kompetenca digjitale *(nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*** |
| • Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik). |

# I.3. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Programi i gjeografisë (i shkallës së tretë) zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.
- Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.
- Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës<br>SHKALLA 3** |
|---|
| **Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike** |
| Nxënësi:<br>• Formulon dhe drejton pyetje për çështjen gjeografike, për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik.<br>• Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij/saj ose duke formuluar hipoteza.<br>• Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe në mjedisin lokal. |
| **Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit** |
| Nxënësi:<br>• Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.<br>• Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.<br>• Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi etj.<br>• Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik. |
| **Marrja e vendimeve** |
| Nxënësi:<br>• Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh. një parashikim apo një gjetje kyçe.<br>• Identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.<br>• Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?” |

# I.5. Rolet që ndërmarrin nxënësi / ja dhe mësuesi / ja gjatë procesit të të nxënit:

***Nxënësi/ja aktiv dhe i interesuar***. Në gjeografi, nxënësi/ja studion dukuritë dhe proceset gjeografike, ndërton kuptimin për vendin e tij. Ai/ajo inkurajohet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi/ja angazohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij/saj; bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin/en, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai/ajo punon individualisht ose në grup dhe mbështetet nga mësuesi/ja.

***Mësuesi/ja udhëheqës dhe lehtësues.*** Mësuesi/ja i gjeografisë ndihmon nxënësit/et të zbulojnë kënaqësitë e të nxënit. Roli i mësuesit/es konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai/ajo moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit/et veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin/en të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ato krijojnë kontekste të nxëni të cilat i aftësojnë nxënësit/et të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi/ja të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënit të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

# I.6. Çfarë situatash duhet të përdoren në funksion të të nxënit

- *Situatat e të nxënit* në gjeografi duhet të jenë të larmishme dhe komplekse. Nxënësi/ja duhet të përceptojë lidhjen ndërmjet përvojave të tij/saj të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme.
- *Situatat duhet të jenë të hapura*, që do të thotë që nxënësi/ja aftësohet të kërkojë zgjidhje të ndryshme për një çështje apo problem dhe jo një zgjidhje të vetme apo një përgjigje të vetme. Situata të tilla përfshijnë detyra të ndryshme, favorizojnë përdorimin e mediave të ndryshme dhe rezultojnë me punime të llojeve të ndryshme.
- *Situatat e të nxënit duhet të jenë komplekse*, që do të thotë të përdoren burime të ndryshme të të nxënit dhe nxënësit/et të punojnë së bashku. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënit. Ata/ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

# I.7. Në sa mënyra vlerëson mësuesi / ja?

Mësuesit/et duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit/et) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.




Përdorimi i portofolit, si një koleksion sistematik i punës së nxënësve, siguron një tablo të plotë të zhvillimit e të progresit të nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai u ofron nxënësve gjithashtu mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

# II. MODELE TË PLANIFIKIMIT VJETOR, 3-MUJOR DHE DITOR TË MËSUESIT

## II.1. Modeli i planifikimit vjetor

- Ø **PLANI MËSIMOR VJETOR - KLASA VI**
- Ø **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
- Ø **LËNDA: GJEOGRAFI**

| **TEMATIKA** | **SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS** | | |
|---|---|---|---|
| | **SHTATOR – DHJETOR (13 ORË)** | **JANAR – MARS (12 ORË)** | **PRILL – QERSHOR (10 ORË)** |
| **Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve**<br><br>**(35 orë)** | **Nëntematika I-Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | **Hartat gjeografike (vazhdim)** | **-Mjedisi lokal (vazhdim)** |
| | **1-** Gjeografia dhe roli i saj | **1-** Rrjeta gjeografike | **1-** Pasuria ujore në vendbanimin tuaj |
| | **2-** Disa periudha të rëndë-sishme të zhvillimit të njohurive gjeografike | **2-**Koordinatat gjeografike | **2-** Klima dhe bota e gjallë në vendbanimin tuaj |
| | **3-** Degët e gjeografisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera | **3-** Punë praktike Nr.2.2. Tema: Përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike | **3-** Popullsia në vendbanimin tuaj |
| | **4-** Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik | **4-** Shkalla e hartës | **4-** Lloji i vendbanimit tuaj dhe aktivitetet prodhuese të tij |
| | **5-** Pesë temat bazë të gjeografisë | **5-** Punë praktike Nr. 2.3. Tema: Ndërtimi i një plani (të një dhome/të një klase) | **5-** Trashëgimia natyrore dhe kulturore e vendbanimit tuaj |

| TEMATIKA | SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS | | |
|---|---|---|---|
| | **SHTATOR – DHJETOR (13 ORË)** | **JANAR – MARS (12 ORË)** | **PRILL – QERSHOR (10 ORË)** |
| | **6-** Rajoni | **6-** Punë praktike Nr 2.4. Tema: Si të orientohemi me shkallën e hartave të ndryshme | **6-** Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror të zonës suaj |
| | **7-** Lëvizja | **7-** Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre | **7-** Punë praktike Nr 3.1 (2 orë). Tema: Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj (ora e parë) |
| | **8-** Bashkëveprimi njeri-natyrë | **8-** Përsëritje II | **8-** Punë praktike Nr 3.1 (2 orë). Tema: Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj (ora e dytë) |
| | **9-** Përsëritje | **Nëntematika III -Mjedisi lokal** | **9 -** Përsëritje III |
| | **Nëntematika II-Hartat gjeografike** | **9-** Vendndodhja gjeografike e vendbanimit tuaj | |
| | **10-** Paraqitja grafike e Tokës | **10-** Projekt (ora e parë). Tema: Vendbanimi im | **10-** Projekt (ora e dytë) Tema: Vendbanimi im |
| | **11-** Punë praktike II.1. Tema: Çfarë ndryshimi ka midis informacionit që marrim prej globit, hartës dhe planit | **11-**Tiparet e relievit në vendbanimin tuaj | |
| | **12-** Përmbajtja e hartës | **12-** Test-2 | |
| | **13-** Test-1 | | |

# II.2 Modeli i planifikimit mujor (*me disa situata model*)

## FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

## LËNDA: GJEOGRAFI

**PLANI 3 MUJOR (SHTATOR-DHJETOR -13 orë); KLASA VI**

**FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

1. **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit për: objektin, degët dhe rolin e gjeografisë, periudhat kryesore të zhvillimit të njohurive gjeografike, për pesë temat bazë të gjeografisë, si dhe për ndryshimet midis planit/hartës/globit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi objektin e degët e gjeografisë, burimet dhe metodat që përdor një gjeograf, pesë temat bazë të gjeografisë (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm).
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj. e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

2. **Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati (p.sh. lidhjen midis gjeografisë me shkenca të tjera; zgjidhjet e një gjeografi mbi situata të ndryshme që kërkojnë zgjidhje, ndryshimet midis planit/hartës/globit etj).
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse (p.sh. zgjidhjet që jep gjeografi për rrëshqitjet në një terren të pjerrët etj).
- Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë rolin e gjeografisë për jetën e përditshme dhe rolin e kërkimit gjeografik në njohjen mbi botën.

- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar njohja mbi botën.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis metodave që përdor gjeografi në studimet dhe zgjidhjet e tij.

**3. <u>Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)</u>**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, foto, harta të ndryshme, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, internet, media etj. për të nxënë, në detyrën që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një renditjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

**4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive*)</u>**

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (detyre/projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**5. <u>Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme*)</u>**

- Ndan përvoja dhe mendime në grup.

**6. <u>Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)</u>**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

**7. <u>Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*</u>**

- Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**<u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës</u>**

**1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>**

Nxënësi/ja:

- Formulon dhe drejton pyetje për rolin e gjeografisë në jetën e përditshme, për pesë temat bazë të gjeografisë, për rolin e planit/hartës/globit.
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza, p.sh. për ndryshimet midis planit/hartës/globit.

**2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>**

Nxënësi/ja:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim (p.sh. harta, foto të ndryshme).
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Ndërton njohuri për mjedisin lokal duke përdorur hartat, vëzhgimet në terren, fotografi etj. në çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin midis shoqërisë dhe mjedisit.

**3. <u>Marrja e vendimeve</u>**

Nxënësi/ja:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh. një parashikim apo një gjetje kyç.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”

## SHTATOR-DHJETOR (13 orë)

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve<br><br>Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik (9 orë) | Nxënësi/ja:<br>Demonstron përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/ vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi, zhvillimi.<br>Përshkruan metodat shkencore të kërkimit gjeografik: përdorimi i burimeve parësore dhe dytësore. Analiza dhe interpretimi i të dhënave.<br>Diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.<br>Diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik. | 1-Gjeografia dhe roli i saj | Situata 1: Ngrihet diskutimi mbi fotot e paraqitura në tekst (ku paraqitet një mjedis natyror dhe një human i tokës). Përveç tyre, paraqiten edhe foto të tjera që paraqitin mjedise natyrore (fizike) dhe humane të tokës. Ftohen nxënësit/et të përshkruajnë se çfarë elementesh shohin. Disa prej fotove të ofruara prej mësuesit-es mund të paraqesin të njëjtën sipërfaqe toke në periudha të ndryshme kohore, në mënyrë që nxënësit të dallojnë ndryshimet. Më pas drejtohet pyetjet:<br>• Pse ka ndryshuar kjo sipërfaqe? A ndikojnë këto në jetën tonë?<br>• Te cila shkencë duhet të mbështetemi për të marrë informacionin e duhur për këtë? | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedim;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat. | -Vlerësim me gojë;<br>-Vlerësim i punës në grup;<br>-Vlerësim i punës prak-tike;<br>-Vlerësim i detyrës së shtëpisë;<br>-Vlerësim i eseve;<br>-Vlerësim me shkrim;<br>Vlerësim i lojës me role | Teksti i gjeografisë<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës.<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.<br><br>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi<br>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video.<br>Materiale të përgatitura me power-point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit/et. |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në vazhdim, diskutohen situ-ata të ndryshme se si ndihmon gjeografia në jetën e përditshme. Mësuesi/ja orienton nxënësit se si i ndihmon ata gjeografia në jetën e përditshme. P.sh. në orientimin me terrenin, me anët e horizontit, me kushtet e motit etj. | | | |
| 2 | | | 2-Disa periudha të rëndësishme të zhvillimit të dijeve gjeografike | Situata 2: (Brainstorming & Debat). Ekspozohen në klasë harta të Botës. Parashtrohet situata: Sot e kemi të lehtë të orientohemi në terren. Mund të gjejmë informacione dhe të përdorim harta të ndryshme, madje hartat mund t'i gjejmë edhe në aparatët tanë celularë. Përmes satelitëve mund ta shohim planetin tonë nga kozmosi dhe mund të orientohemi lehtësisht në çdo cep të tij.<br>-Ftohen nxënësit/et në disku-tim: A ka qenë e mundur kjo më parë? A e njihnin njerëzit e hershëm, çdo vend në glob?<br>-Paraqiten me video projektor harta të ndryshme (ose | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedim;<br>Përdorimi TIK;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat;<br>Lojë me role; | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | video) të vjetra që tregojnë evolucionin e njohjeve mbi tokën.<br>-Nxiten nxënësit/et të hulumtojnë më pas mbi zbulimet e mëdha gjeografike dhe të zgjedhin të jenë (të përshkruajnë rrugën) në rolin e njërit prej eksploratorëve të asaj periudhe (Magelani, Kolombi etj). | | | |
| 3 | | | 3-Degët e gjeografisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera. | Situata 3: Përdoret shembulli i një funksionimit të një biblioteke. Ftohen nxënësit në diskutimin e ngritur nga pyetjet: Ç'kuptoni me një bibliotekë? Si funksionon ajo? etj. Nga diskutimi del përfundimi se: ashtu si në një bibliotekë, në raftet e së cilës gjen të ndara libra që përmbajnë informacion për fusha të ndryshme të botës/të jetës/të zhvillimit, edhe gjeografia ka fushat e saj ("raftet") të studimit (secila me specifikat e saj). Përveç kësaj theksohet gjithashtu, se analizat dhe përfundimet që arrin gjeografia si shkencë, nuk mund | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedim;<br>Përdorimi TIK;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime; | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të bëhen pa ndërveprimin e shkencave të tjera. Për këtë bëhet paralelizëm me faktin që për të shkruar secilin prej librave të vendosura në raftet e bibliotekës, duhet të kesh njohuri nga shumë fusha, apo edhe duhet të hulumtosh, vëzhgosh apo studiosh problemin në një vend e për një kohë të caktuar. Hulumtohet dhe përcaktohen lidhjet midis gjeografisë me historinë, biologjinë, kiminë, fizikën etj. | Debat;<br>Lojë me role; | | |
| | | | 4-Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik | Situata 4: Ftohen nxënësit/et të ndarë në grupe të diskutojnë mbi situatën e paraqitur në tekst: “Gjeografët kanë një mënyrë unike të të vështruarit të botës sonë. Në figurën nr. 15, ju shihni një zonë që mund t’ju duket si një vend shumë i bukur për t’u vizituar. Një urbanist mund ta shohë si një zonë ideale për të ndërtuar një zonë turistike. Një fermer mund ta mendojë si një zonë të përshtatshme për të mbjellë vreshta ose ullinj. | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;<br>Përdorimi TIK;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat;<br>Lojë me role; | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Një gjeograf i mendon si të mundshme, të gjitha përdorimet e mësipërme, pasi studion të gjitha mundësitë dhe kufizimet që ka zona”.<br>Diskutohen përgjigjet e dhëna nga gjeografi.<br>Diskutohen shembuj të ngjashëm.<br>Më pas kalohet në veprimtari konkrete të të nxënit, ku nxënësi/ja e vë veten në rolin e një gjeografi që duhet të japë zgjidhje. Nxënësi/ja ndjek hapat e punës së një gjeografi: vëzhgimi, regjistrimi, interpretimi, përfundime dhe propozime për zgjidhje (për rrugën që do të ndjekin, nxënësit bazohen te shembulli nr.1, paraqitur në libër). Pra nxënësit “... japin zgjidhje për dukurinë e rrëshqitjes së tokës në një terren të pjerrët, ku mungon bimësia”. Në përfundim nxënësit:<br>• ndjekin dhe hartojnë një raport përfundimtar me zgjidhje të përkohshme dhe përfundimtare; | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • përcaktojnë se çfarë burimesh dhe metodash përdorën gjatë realizimit të punës së tyre;<br>• përcaktojnë rëndësinë që solli ndërhyrja e një gjeografi në zgjidhjet e dhëna. | | | |
| 5 | | | 5-Pesë temat bazë të gjeografisë | Situata 5: Mësuesi/ja shfrytëzon njohuritë paraprake që nxënësit/et kanë në lidhje me rastet e shpeshta dhe përhapjen gjeografike të përmbytjeve në Shqipëri. Ai/ajo shtron për diskutim problematikën (e vendosur në tekst) për nxënësit/et: “Përmbytjet e vazhdueshme në veri por edhe në jug të Shqipërisë, konsiderohen si një dukuri katastorfike për jetën dhe ekonominë e banorëve por edhe për zhvillimet e vendit tonë. Cilat janë shkaqet dhe si mund të zgjidhet kjo situatë? Nëpërmjet vëzhgimit dhe analizës së kësaj situate, nxënësit perceptojnë lidhjen dhe zbatimin e koncepteve bazë të kërkimit gjeografik | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;<br>Përdorimi TIK;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat; Lojë me role; | | |
| 6 | | | 6-Rajoni | | | | |
| 7 | | | 7-Lëvizja | | | | |
| 8 | | | 8-Bashkëveprimi njeri-natyrë | | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në realitetin konkret dhe përdorimet e tyre në jetën e përditshme. Mësuesi/ja e paraqet këtë situatë që në këtë temë dhe në vazhdim, për çdo prej 5 temave bazë të gjeografisë: Vendndodhja: Nxënësit/et hulumtojnë në harta të ndryshme për vendet në të cilat kanë ndodhur vazhdimisht përmbytje dhe përcaktojnë vendndodhjen relative dhe absolute të tyre.<br>Vendi: Nxënësit/et hulumtojnë në harta të ndryshme për vendet në të cilat kanë ndodhur vazhdimisht përmbytje dhe përcaktojnë tiparet (fizike, humane) e secilit prej tyre. Rajoni: Nxënësit/et përshkruajnë karakteristikat (fizike, humane) të vendeve që i dallojnë nga vendet e tjera dhe që i grupojnë ato si një rajon (p.sh.: “rajoni i vendeve që preken vazhdimisht nga përmbytjet”). | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Lëvizja dhe bashkëveprimi njeri-natyrë: Nxënësit/et hulumtojnë si njerëzit lëvizin midis vendeve/rajoneve dhe se çfarë ndërveprimi ka dhe duhet të ketë midis njeriut e natyrës në këto zona (si p.sh. diskutohet si ndikojnë migrimet dhe vendosja e njerëzve pranë shtretërve të lumenjve si dhe aktivitetet pa kriter të tyre përgjatë luginave lumore). | | | |
| 9 | | | 9-Përsëritje | | Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role; | | |
| 10 | Nëntematika II: Hartat gjeografike (12 orë) | Nxënësi/ja: Krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. | 10-Paraqitja grafike | Situata 6.1: Ekspozohen në klasë: globi, harta politiko-administrative e Italisë, harta e plani i Romës dhe ftohen nxënësit të krahasojnë informacionin dhe të diskutojnë mbi situatën e ngritur: | Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Hulumtim dhe zbulim; | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | | Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre. | 11-Punë praktike II.1-Tema: Çfarë ndryshimi ka midis informacionit që marrim prej globit, hartës dhe planit | ‘Vëllai/motra jote do të shkojë për studime në Romë dhe i duhet informacion mbi: vendndodhjen e universitetit, planimetrinë e tij, distancën e universitetit me objekte të njohura prej tij, rrugët që të çojnë në këtë universitet etj. Për të grumbulluar informacionin e nevojshëm, fillimisht, ti mund ti drejtohesh globit, hartës së Italisë/Romës dhe planit të zonës ku ndodhet universiteti, pasi ato janë tre forma të paraqitjes grafike të sipërfaqes së Tokës. Çfarë informacioni mund të ofrojnë secila prej tyre?<br>Situata 6.2: Ekspozohen në klasë: globi, harta të ndryshme (fiziko-gjeografike, politiko administrative, klimatike, e popullsisë, etj) dhe plani i i zonës ku banon nxënës/ja.<br>Ftohen nxënësit/et të gjejnë se sa informacion marrin për zonën në të cilën ndodhen (ose për Shqipërinë), me anë të përdorimit të globit, hartave dhe planit. Duke krahasuar globin, | Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat; Konkurs;<br>Lojë me role; | | |
| 12 | | | 12-Përmbajtja e hartës | | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | hartat dhe planin, nxënësi/ja:<br>• tregon ngjashmëritë dhe dallimet mes globit hartave dhe planit;<br>• dallon lloje të ndryshme hartash.<br>Situata 6.3: Nxënësit/et mund të luajnë role të ndryshme (të globit, hartave dhe planit), ku përmes diskutimit midis tyre të tregojnë se cila është “dobia dhe mangësitë” e secilit prej tyre. | | | |
| 13 | | | 13 - Test-1 | | | | |

# PLANI 3 MUJOR (JANAR-MARS -12 orë); KLASA VI

## FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

## LËNDA: GJEOGRAFI

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpreh mendimin e vet për rëndësinë e përdorimit të hartave të ndryshme, të përdorimit të shkallës së zvogëlimit, të njohjes dhe të hulumtimit mbi mjedisin lokal etj.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët për to, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (meridianë, Meridiani i Grinuiçit, Meridiani $180^0$, Ekuator, paralele, koordinata gjeografike, shkallë zvogëlimi, legjendë, simbole, vendbanim), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

**2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Përzgjedh dhe demonstron zgjidhje të ndryshme p.sh. për llogaritjen e distancave reale në terren dhe paraqitjen e tyre në hartë, duke paraqitur rezultat të njëjtë.
- Interpreton përmbajtjen e hartave të ndryshme, duke e ilustruar me shembuj konkretë; vendodhjen gjeografike dhe tiparet e relievit të vendbanimit të tij/saj.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet në përmbajtjen e hartave të ndryshme.

**3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, harta të ndryshme, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.

- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve: meridianë, Meridiani i Grinuiçit, Meridiani $180^0$, Ekuator, paralele, koordinata gjeografike, shkallë zvogëlimi, legjendë, simbole, vendbanim, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë ose për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit, sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikën që trajtohet/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo në terren).

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (miniprojekti/aktiviteti/ detyre p.sh. të përcaktojë tiparet e relievit të vendbanimit të tij/saj etj).

**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme*)**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

1. **Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja:

- Formulon dhe drejton pyetje mbi konceptet: meridianë, Meridiani i Grinuiçit, Meridiani $180^0$, Ekuator, paralele, koordinata gjeografike, shkallë zvogëlimi, legjendë, simbole, vendbanim.
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza.
- Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë në tiparet e relievit të vendbanimit të tij.

2. **Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, fotove etj., duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

3. **Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit "Çfarë funksionoi?", "Si mund të përmirësohet?".

JANAR-MARS (12 orë)

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Hartat gjeografike | Nxënësi/ja:<br>Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre.<br>Përdor TIK-un:<br>-për të gjetur harta elektronike të llojeve të ndryshme;<br>-për të përcaktuar vendndodhjen dhe largësinë midis dy vendeve.<br>Shpjegon legjendën e një harte gjeografike;<br>Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme;<br>Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në | 1-Rrjeta gjeografike | Situata 7.1: Ekspozohen në klasë: globi dhe harta të ndryshme. Ftohen nxënësit të dallojnë dhe të përshkruajnë rrjetën gjeografike në glob dhe të risjellin në vëmendje rrjetën e krijuar prej tyre në një top llastiku (gjatë punës praktike 2.1).<br>Situata 7.2: Ekspozohen në klasë harta të ndryshme (fiziko-gjeografike, politiko-administrative, të klimës, të bimësisë, etj) të botës, të Evropës, ose të Shqipërisë dhe ftohen nxënësit të krahasojnë sesi ndryshon përmbajtja e hartave në varësi të qëllimit dhe shkallës. P.sh., se si ndryshon pëmbajtja e hartave në figurat 5 dhe 6, se se si rritet informacioni për objektet e ndodhura në | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;<br>Përdorimi TIK;<br>Projekte kurrikulare;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime;<br>Debat; Konkurs;<br>Lojë me role; | -Vlerësim me gojë;<br>-Vlerësim i punës në grup;<br>-Vlerësim i punës praktike;<br>-Vlerësim i detyrës së shtëpisë;<br>-Vlerësim i eseve;<br>-Vlerësim me shkrim;<br>-Vlerësim i lojës me role. | Teksti i gjeografisë<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës.<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.<br><br>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi<br>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video<br>Materiale të përgatitura me power-point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit/et. |
| 15 | | | 2-Koordinatat gjeografike | | | | |
| 16 | | | 3-Punë praktike Nr 2.2. Tema: Përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike | | | | |
| 17 | | | 4-Shkalla e hartës | | | | |
| 18 | | | 5-Punë praktike Nr 2.3. Tema: Ndërtimi i një plani (të një dhome/të një klase). | | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | | hartë përmes koordinatave gjeografike.<br>Dallon:<br>-paraqitjen e Shqipërisë në harta të llojeve të ndryshme;<br>-vendndodhjen gjeografike (absolute dhe relative) të Shqipërisë në hartën e Ballkanit, Evropës dhe botës.<br>Përshkruan një itinerar në hartë kur janë dhënë drejtimet kryesore të lëvizjes dhe objekte gjeografike të dallueshme. | 6-Punë praktike Nr 2.4. Tema: Si të orientohemi me shkallën e hartave të ndryshme | bllokun numër 2 të banesave nga harta e figurës 17/a deri në atë 17/d (në tekst).<br>Situata 7.3: Kjo situatë mund të përdoret në të gjitha temat e kësaj nëntematike.<br>-Për rrjetën gjeografike:<br>Ekspozohen në klasë:<br>globi, harta të ndryshme (fiziko-gjeografike, politiko administrative, klimatike, e popullsisë etj). Ekspozohen përmes laptop-it harta të ndryshme të gjetura elektronikisht. Ftohen nxënësit të gjejnë rrjetën gjeografike në secilën prej tyre.<br>-Për koordinatat gjeografike:<br>Ekspozohen në klasë: globi, harta të ndryshme (fiziko-gjeografike, politiko administrative etj). Nxënësit përcaktojnë në secilën prej tyre koordinatat gjeografike të vendeve të ndryshme. | | | |
| 20 | | | 7-Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre | | | | |
| 21 | | | 8- Përsëritje II | | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mjedisi ynë lokal | | | -Për shkallën e hartës: Ekspozohen në klasë: harta të ndryshme me shkallë të ndryshme zvogëlimi (fiziko-gjeografike, politiko administrative etj). Nxënësit lexojnë, orientohen dhe përdorin shkallën e hartës dhe legjendën në secilën prej hartave. Nxënësit/et, të ndarë në grupe, masin distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme<br>-Për hartat gjeografike dhe përdorimin e tyre:<br>Situata 8: Nxënësit/et të ndarë në grupe grumbullojnë një prej llojeve të hartave. Një prej grupeve ndërton në një tabak të madh skemën që përmbledh llojet e hartave dhe e ekspozon në klasë (si ajo e paraqitur në libër). Secili prej grupeve të tjerë shkon dhe i bashkangjit tabakut llojet e hartave (të printuara) | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | që përfshihen në grupimin përkatës (për të cilin është ngarkuar të hulumtojë e gjejë në formë elektronike) të skemës së përgatitur.<br>Në përfundim diskutohet sipas grupeve përmbajtja e hartave dhe rëndësia e përdorimit të tyre | | | |
| 22 | | Nxënësi/ja:<br>Interpreton në hartë vendndodhjen e zonës (qytetit/fshatit) ku banon.<br>Përshkruan përbërësit kryesorë të relievit duke dalluar elementë të veçantë;<br>Vëzhgon dhe sjell shembuj si kanë ndikuar këto burime në jetën e banorëve; | 9-Vendndodhja gjeografike e vendbanimit tonë | Situata 9.1: Si situatë, shërben informacioni që jepet në tekst për Shqipërinë, “si vendbanimi ynë i madh”, në fillim të çdo teme mësimore. Kjo situatë përdoret gjatë gjithë nëntematikës. Fillimisht mësuesi/ja diskuton së bashku me nxënësit/et informacionin e dhënë të tekst, mbi Shqipërinë. Në vazhdim mësuesi/ja jep disa shënime bazë mbi çështjen e trajtuar, për vendin ku jetojnë. Më pas, duke u ndihmuar edhe nga shënimet e dhëna, mësuesi/ja i orienton nxënësit që | | | |
| 23 | | | 10- Projekt (ora e parë). Tema: Vendbanimi im | | | | |
| 24 | | | 11-Tiparet e relievit në vendbanimit tonë | | | | |

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të hulumtojnë, të vëzhgojnë dhe të prezantojnë gjetjet e tyre mbi secilën prej çështjeve që trajtohet për vendbanimin e tij. Situata 9.2: Si situatë mund të shërbejnë edhe gjetjet e nxënësve, gjatë hulumtimit për realizimin e projektit me temë “Vendbanimi im”. Meqënëse gjatë realizimit të projektit, (të ndarë në role brenda grupit) nxënësit hulumtojnë, grumbullojnë dhe analizojnë informacionet në lidhje me çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit, atë mund të diskutojnë për çdo orë gjetjet e tyre mbi: relievin, pasuritë minerale, lëndët e ndërtimit, klimën, hidrografinë, popullimin, aktivitetin ekonomik, trashëgiminë natyrore/kulturore, problemet mjedisore, etj. në vendbanimin e tij/saj. | | | |
| 25 | | | 12 - Test-2 | | | | |

# PLANI 3 MUJOR (PRILL – QERSHOR 10 orë); KLASA VI

## FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

## LËNDA: GJEOGRAFI

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)</u>**

- Shpreh mendimin e vet, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit mbi: pasurinë ujore, klimën, botën e gjallë, popullimin, ativitetet prodhuese dhe llojin e vendbanimit, trashëgiminë natyrore e kulturore të tij, si dhe mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin lokal.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (pasuri ujore, klimë, botë e gjallë, popullim, lloji i vendbanimit e aktivitetet prodhuese të vendbanimit, trashëgimi natyrore e kulturore të tij, si dhe mbi ndikim të veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin lokal), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, harta, foto etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

**2. <u>Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)</u>**

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media, p.sh. mbi ndotjen (në toka, në ajër, në ujë etj ) në vendbanimin e tij/saj.
- Arsyeton mbi informacionin që hulumton mbi vendbanimin e tij/saj.
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (p.sh. ndotjen në mjedis, dëmtime mbi trashëgiminë natyrore e kulturore) duke paraqitur rezultat të njëjtë.

- Interpreton të dhëna të ndryshme mbi pasurinë ujore, klimën, botën e gjallë, popullimin, ativitetet prodhuese dhe llojin e vendbanimit, trashëgiminë natyrore e kulturore të tij/saj, si dhe mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin lokal.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet midis veçorive natyrore, kushteve të jetesës dhe aktiviteteve prodhuese në vendbanimin e tij/saj me ato në përgjithësi në Shqipëri.

**3. <u>Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)</u>**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, të dhëna të marra nga publikime të qeverisjes vendore, enciklopedi, internet, ose vëzhgime në terren), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrave të dhëna dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi: tiparet natyrore dhe humane të vendbanimit të tij/saj, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimet e përdorura për detyrën që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një renditjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikë që trajtohet/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

**4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)</u>**

- Duke zhvilluar projektin "Vendbanimi im", realizon edhe shërbime në ndihmë të përmirësimit të mjedisit të shkollës ose të komunitetit të tij/saj.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e banorëve dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët, për realizimin e aktivitetit të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

5. **<u>Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme*)</u>**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

6. **<u>Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)</u>**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

7. **<u>Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)</u>**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

## <u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës</u>

1. **<u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>**

Nxënësi/ja:

- Formulon dhe drejton pyetje mbi veçoritë që ka: pasuria ujore, klima, bota e gjallë, popullimi, ativitetet prodhuese dhe lloji i vendbanimit, trashëgimia natyrore e kulturore të tij, si dhe ndikimi i veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin lokal.
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij/saj.
- Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në mjedisin lokal.

2. **<u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>**

Nxënësi/ja:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.

- Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi etj.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

**3. <u>Marrja e vendimeve</u>**

Nxënësi/ja:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit "Çfarë funksionoi?", "Si mund të përmirësohet?".

**PRILL-QERSHOR (10 orë)**

| Nr. | Tematika/ Nëntematika | Rezultatet e të nxënit sipas tematikave | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | | Nxënësi/ja:<br>Përshkruan burimet ujore (burime, lumenj, liqene, dete etj.); botën bimore dhe shtazore; mikroklimën në mjedisin ku jeton.<br>Vëzhgon dhe sjell shembuj si kanë ndikuar këto burime në jetën e banorëve; | 1- Pasuria ujore në vendbanimin tonë. | Situata 9.1: Si situatë, shërben informacioni që jepet në tekst për Shqipërinë, "si vendbanimi ynë i madh", në fillim të çdo teme mësimore. Kjo situatë përdoret gjatë gjithë nëntematikës. Fillimisht mësuesi diskuton sëbashku me nxënësit/set informacionin e | Punë në grup;<br>Punë në dyshe;<br>Punë individuale;<br>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;<br>Përdorimi TIK;<br>Projekte kurrikulare;<br>Hulumtim dhe zbulim;<br>Brainstorming;<br>Diskutime; | -Vlerësim me gojë;<br>-Vlerësim i punës në grup;<br>-Vlerësim i punës praktike;<br>-Vlerësim i detyrës së shtëpisë;<br>-Vlerësim i ese-ve;<br>-Vlerësim me shkrim;<br>-Vlerësim i lojës me role. | Teksti i gjeografisë<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës.<br>Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.<br>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi. |
| 27 | | | 2- Klima dhe bota e gjallë në vendbanimin tonë | | | | |
| 28 | | | 3- Popullsia në vendbanimin | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | | Diskuton mbi rrugët nëpërmjet të cilave njerëzit kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore (p.sh., përdorimi i gurëve, rërës, ndërtimi i hidrocentraleve etj.). Përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton; Mbledh të dhëna statistikore për të shpjeguar lëvizjet e popullsisë së zonës në periudha të ndryshme dhe shkaqet. Dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/ fshatin e tij. Krahason: mënyrën e jetesës së popullsisë në mjedisin e tij lokal me atë të popullsisë në mjedise të tjerë. Evidenton: monumentet e | 4- Lloji i vendbanimit dhe aktivitetet prodhuese të tij | dhënë të tekst, mbi Shqipërinë. Në vazhdim mësuesi jep disa shënime bazë mbi çështjen e trajtuar, për vendin ku jetojnë. Më pas, duke u ndihmuar edhe nga shënimet e dhëna, mësuesi/ja i orienton nxënësit që të hulumtojnë, të vëzhgojnë dhe të prezantojnë gjetjet e tyre mbi secilën prej çështjeve që trajtohet për vendbanimin e tij/saj. Situata 9.2: Si situatë mund të shërbejnë edhe gjetjet e nxënësve, gjatë hulumtimit për realizimin e projektit me temë "Vendbanimi im". Meqënëse gjatë realizimit të projektit, (të ndarë në role brenda grupit) nxënësit/et hulumtojnë, grumbullojnë dhe analizojnë informacionet në lidhje me çështjet që do të trajtohen gjatë | Debat; Konkurs; Lojë me role; | | Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video. Materiale të përgatitura me power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit/et. |
| 30 | | | 5- Trashëgimia natyrore dhe kulturore e vendbanimit tonë. | | | | |
| 31 | | | 6- Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror të vendbanimit tonë. | | | | |
| 32 | | | 7- Punë praktike Nr 3.1(2 orë). Tema: Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj (ora e parë) | | | | |
| 33 | | | 8- Punë praktike Nr 3.1(2 orë) Tema: Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj (ora e dytë) | | | | |
| 34 | | | 9- Përsëritje III | | | | |
| 35 | | | 10 - Projekt (ora e dytë). Tema: "Vendbanimi im" | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës; vlerat turistike që kanë monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës; rreziqet natyrore dhe antropogjene që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës.<br>Identifikon: llojet kryesore të veprimtarive prodhuese ekonomike, industriale dhe tregtare në mjedisin lokal.<br>Përcakton: vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore, objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.<br>Parashtron ide (me shkrim dhe me gojë) mbi ndikimin e veprimtarisë së | | realizimit të projektit, atë mund të diskutojnë për çdo orë gjetjet e tyre mbi: relievin, pasuritë minerale, lëndët e ndërtimit, klimën, hidrografinë, popullimin, aktivitetin ekonomik, trashëgiminë natyrore/kulturore, problemet mjedisore etj., në vendbanimin e tij. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njeriut në mjedisin natyror të zonës dhe nevojën e bashkëpunimit komunitet-qeverisje lokale për mbrojtjen e mjedisit;<br>Përdor hartën topografike të qytetit/fshatit për t'u orientuar në mjedisin e tij lokal. | | | | | |

# II.3.PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (modele skematike)

***Shënim:*** Edhe pse në planifikimet e mëposhtme ditore të orëve mësimore, janë paraqitur për çdo orë, rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe, nuk është detyrim që brenda një ore mësimore ato të realizohen të gjitha (të shtata kompetencat), por vetëm disa prej tyre. Paraqitja e plotë e tyre e pasqyruar në çdo orë mësimore, është bërë:

- për shkak të respektimit të formatit të një ore mësimore;
- me qëllim paraqitjen në të, të çdo detaji që do të ndihmonte në orentimin e punës së mësuesit/es;
- për të paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pritshmëritë që mund të ketë secila prej orëve mësimore.

# Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik

# Tema mësimore: I.1 Gjeografia dhe roli i saj

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.1 Gjeografia dhe roli i saj** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**
- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, (si dhe në forma të tjera të komunikimit) mbi objektin e gjeografisë dhe rolin e saj.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre,duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.

**2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**
- Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë rolin e gjeografisë.

**3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)**
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën dhe shfrytëzimin e materialeve gjatë kryerjes së detyrës.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)**
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***
- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**
- Kontribuon në rritjen e cilësisë së përgjigjeve të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi rolin e gjeografisë.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja formulon dhe drejton pyetje mbi objektin e gjeografisë dhe rolin e saj.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja ndërton njohuri mbi rolin e gjeografisë për profesionet e tjera dhe në të përditshmen tonë.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja identifikon fusha të ndryshme që bëhen objekt i gjeografisë dhe vlerëson rolin e gjeografisë.

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Demonstron interes për gjeografinë, degët e saj dhe karrierat që lidhen me të. | **Fjalët kyçe:** gjeografi, roli i gjeografisë. |

| | |
|---|---|
| **Burimet:** Teksti, foto që paraqisin mjedise të ndryshme në tokë. (natyrore dhe humane). | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në kuriozitetin e vazhdueshëm që i karakterizon nxënësit/es, në të përditshmen e tyre dhe në dëshirën e vazhdueshme të tyre për të mësuar rreth botës që i rrethon. Përdor pyetje të cilat ata mund t'i kenë bërë në jetën e përditshme. P.sh. mësimi fillon me pyetjen: Sa kuriozë jeni për botën që ju rrethon? Cilat janë disa pyetje që keni bërë për të mësuar më tepër mbi botën që ju rrethon? |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1.<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1 në tekst: Diskutojmë: 'Përshkruan pamjet e paraqitura në figurat 1 dhe 2 dhe dallon një mjedis natyror e një mjedis të transformuar prej njeriut. Menjëherë mund të lindin një sërë pyetjesh: ku ndodhen këto vende; si janë krijuar; si dhe pse kanë ndryshuar; ku mund të mësoj më shumë për këto vende etj.<br>Nxënësit/et diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë.<br>Mësuesi/ja vazhdon: Në jetën tonë të përditshme, mund të na lindin edhe pyetje të tjera që kanë lidhje me shumë dukuri dhe vende që gjenden rreth nesh. P.sh. mund të na lindin pyetje: pse ndodhin tërmetet?, pse shpërthejnë vullkanet? etj.<br>Mësuesi/ja pret prej nxënësve të tregojnë pyetje të ndryshme që ata kanë mbi botën që i rrethon.<br><br>Mësuesi/ja vazhdon: Për të marrë përgjigje për shumë prej pyetjeve tona, si dhe për t'u njohur me tiparet e gjithë hapësirës së planetin tonë, na ndihmon gjeografia. Sepse, gjeografia është shkenca që studion tiparet fizike e humane të Tokës, si dhe bashkëveprimin midis tyre.<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja drejton pyetjet: Po si na ndihmon gjeografia në të përditshmen tonë?<br>Orientohen nxënësit/et të lexojnë shembujt në tekst dhe më pas ftohen përsëri nxënësit të sjellin shembuj sesi ndihmon gjeografia në jetën tënde e tyre të përditshme. Për këtë, nxënësi orientohet më tej: si të ndihmon gjeografia në orientimin me terrenin, kushtet e motit, me anët e horizontit, llojin e bimësisë që rritet në klimën e zonës ku banon etj. |
| | **Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë ushtrimet e dhëna në tekst, në rubrikën "Radha jote". |

| | |
|---|---|
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.2 Disa periudha të rëndësishme të zhvillimit të njohurive gjeografike

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.2 Disa periudha të rëndësishme të zhvillimit njohurive gjeografike** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth periudhave të rëndësishme të zhvillimit të njohurive gjeografike, duke bërë pyetje e komente.

**2. Kompetenca e të menduarit (nxënës/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet midis periudhave të rëndësishme të zhvillimit të njohurive gjeografike.

**3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e secilës prej periudhave.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e detyrave.

**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., të dhëna për njohjen mbi botën gjatë periudhave të rëndësishme të zhvillimit të njohurive gjeografike, ose informacione mbi ekspedita të ndryshme të bëra gjatë periudhës së zbulimeve gjeografike).

<table>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi përshkuan se si ka ndryshuar njohja mbi botën në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e zhvillimit të teknologjisë, hartografisë dhe të përdorimit të mjeteve e formave digjitale në njohjen mbi botën.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik dhe përcakton se cilat shkaqe nxitën dhe rritën njohjen mbi botën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.</td><td>Fjalët kyçe: njohuri gjeografike, zbulime gjeografike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, foto që paraqesin harta të periudhave të ndryshme të njohjes së botës.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Histori, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>a. bota paraqitet në harta të ndryshme.<br>b. gjeografia na jep shumë njohuri mbi botën që na rrethon (nga mjedisi ynë më i afërt deri në gjithë botën).</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br><br>Veprimet në situatë<br>Hapi I: Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1 në tekst: Diskutojmë: “Sot e kemi të lehtë të orientohemi në terren. Mund të gjejmë informacione dhe të përdorim harta të ndryshme, madje hartat mund t’i gjejmë edhe në aparatët tanë celularë. Përmes satelitëve mund ta shohim planetin tonë nga kozmosi dhe mund të orientohemi lehtësisht në çdo cep të tij”.<br>Diskuto: A e njihnin njerëzit e hershëm, çdo vend në glob? Si ka evoluuar njohja jonë mbi botën që na rrethon?<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë....<br><br>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto<br>Mësuesi/ja vazhdon: Njohuritë gjeografike janë të hershme dhe janë pasuruar përkrah zhvillimit të shoqërisë. Fillojnë që me shenjat që lehtësonin orientimin e njerëzve, të gdhendura mbi gurë, eshtra, lëkurë etj...</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | Kur trajtimi mbërrin në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike, mësuesja fton përsëri nxënësit të vërejnë me kujdes hartën e zbulimeve të mëdha gjeografike dhe të marrin pjesë në diskutimin: "Shih me kujdes hartën dhe përshkruaj rrugët që përshkoi: Kristofor Kolombi, Vasko de Gama, Amerigo Vespuçi, Ferdinand Magelani dhe Marko Polo".<br>Orientohen nxënësit të lexojnë në tekst të rejat që solli periudha e zbulimeve të mëdha gjeografike, krahasuar me ato të mëparshme. Shtrohen për diskutim çështjet: Çfarë të rejash solli kjo periudhë krahasuar me ato të mëparshme?<br>Si ka ndryshuar njohja mbi botën së bashku me zhvillimin e shoqërisë njerëzore? Po sot, pse është më e lehtë njohja e botës?<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtimet e rubrikës "Radha jote" dhe ushtrimin 2 tek fletorja e nxënësit. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/ gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/ses fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.3 Degët e gjeografisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera

<table>
<tr><th>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</th><th>LËNDA: GJEOGRAFI</th><th>SHKALLA: III</th><th>KLASA: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik</td><td colspan="2">Tema mësimore: I.3 Degët e gjeografisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth degëve të gjeografisë dhe lidhjeve të saj me shkencat e tjera, duke bërë pyetje e komente.<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (gjeografi fizike, humane, mjedisore), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)<br>• Interpreton lidhjet e gjeografisë me shkencat e tjera, duke e ilustruar me shembuj konkretë.<br>3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)<br>• Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë e marra në temën 1.1 dhe me përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)<br>• Diskuton në grup mbi rolin e gjeografisë në mbrojtjen e mjedisit.<br>5. Kompetenca personale (nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)<br>• Ndan mendimet në grup.<br>6. Kompetenca qytetare (nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimeve në grup.<br>7. Kompetenca digjitale (nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja përshkuan objektin e degëve të gjeografisë.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e degëve të gjeografisë në njohjen mbi botën dhe të mënyrat/rezultatet e lidhjes së saj me shkenca të tjera.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi dallon objektin e studimit të gjeografisë dhe diferencon rolin që ka secila prej degëve të saj në njohjen e mjedisit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi diskuton mbi rolin e gjeografisë në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, duke specifikuar fushën e studimit që kanë tri degët kryesore të saj: gjeografia fizike, humane dhe mjedisore.</td><td>Fjalët kyçe: gjeografi fizike, gjeografi humane, gjeografi mjedisore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, foto që paraqisin: mjedise dhe dukuri fizike, mjedise humane, bashkëveprim të njeriut me natyrën.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, histori, TIK, biologji etj</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>a. Objektin e gjeografisë dhe rolin e saj.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I: Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 në tekst: Diskutojmë: “Risill në vëmendje objektin e gjeografisë dhe rolin e saj”. Çfarë studion gjeografia? Si na ndihmon ajo në jetën tonë të përditshme?<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë....</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: Në sipërfaqen e Tokës dallojmë fusha, kodra, male, lumenj, dete, oqeane etj. Toka është “shtëpia jonë e përbashkët”, në të cilën jetojnë njerëzit, bimët dhe kafshët. Për këtë arsye, hapësirat e ndryshme të saj kanë tipare fizike, njerëzore ose një kombinim i të dyjave. Gjeografia i studion të gjitha këto hapësira, nëpërmjet degëve të saj që janë të shumta. Midis tyre dallojnë: gjeografia fizike, gjeografia humane dhe gjeografia mjedisore. Gjeografia fizike, studion .....<br>Pasi jep konceptin mbi gjeografinë fizike, mësuesi/ja fton përsëri nxënësit/et të vërejnë me kujdes figurën 10 dhe të përshkruajnë disa prej tipareve fizike dhe dukurive natyrore që ata dallojnë në vendin ku jetojnë.<br>Nxënësit/et diskutojnë dhe përshkruajnë....<br>Mësuesja/si përsëri vazhdon me konceptin gjeografi humane: Gjeografia humane, studion .....<br>Pasi jep konceptin mbi gjeografinë humane, mësuesja fton përsëri nxënësit të vërejnë me kujdes figurën 1.1 dhe të përshkruajnë disa prej tipareve humane që ata dallojnë në vendin ku jetojnë.<br>Nxënësit/et diskutojnë dhe përshkruajnë....<br>Mësuesja/si përsëri vazhdon me konceptin gjeografi mjedisore: Gjeografia mjedisore, studion .....<br>Pasi jep konceptin mbi gjeografinë mjedisore, mësuesja fton përsëri nxënësit/et të vërejnë me kujdes figurën 12 dhe të përshkruajnë disa prej tipareve humane që ata dallojnë në vendin ku jetojnë.<br>Nxënësit diskutojnë dhe përshkruajnë....<br>Në vazhdim, mësuesja trajton idenë e lidhjes dhe ndërvarësisë që ka gjeografia me shkenca të tjera. Për këtë ajo fton nxënësit të diskutojnë së bashku me të, figurën 1.3. Gjatë shpjegimit të figurës, është ajo që sqaron se çfarë informacioni i duhet gjeografisë nga secila prej shkencave të vendosura në figurë.<br>Në vazhdim, mësuesja fton nxënësit/et të vërejnë me kujdes figurën 1.4 dhe të disutojnë se si lidhet gjeografia me biologjinë Nxënësit/et përshkruajnë figurën dhe diskutojnë.<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimin 1, 2 dhe 3 tek rubrika “Radha jote”dhe ushtrimin 3 te fletorja e nxënësit. Lihet detyrë shtëpie ushtrimi 4 (faqe 12) |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.4 Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.4 Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth burimeve dhe metodave të kërkimit gjeografik, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

**2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet midis burimeve dhe metodave të kërkimit gjeografik dhe vlerëson rëndësinë e secilës prej tyre.

**3. Kompetenca e të nxënit (nxënës/jai mëson për të nxënë)**

- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi konceptet e mësipërme, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.

**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja përshkuan burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja vlerëson rolin e zhvillimit të teknologjisë, hartografisë dhe të përdorimit të mjeteve e formave digjitale në studimet gjeografike. Nxënësi/ja vlerëson kontributin e gjeografit në gjetjen e zgjidhjeve të duhura.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja diferencon kontributin e gjeografit dhe tregon interes për profesionin e tij/saj.

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë. | **Fjalët kyçe:** gjeograf, burimet e gjeografit, metoda e vrojtimit, eksperimentale, krahasuese, statistikore dhe e parashikimit |

| | |
|---|---|
| **Burimet:** Teksti, foto që paraqesin rolin e gjeografit si dhe burimet, mjetet dhe metodat që ai përdor. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, shkenca natyrore. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
|---|---|
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësit/et dinë:<br>a. Objektin e gjeografisë, degët dhe rolin e saj. |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.4 në tekst dhe fton nxënësit të shohin figurën 15. Diskutojmë: "Një urbanist mund ta shohë, mjedisin e paraqitur në figurën15, si një zonë ideale për të ndërtuar një zonë turistike. Një fermer mund ta mendojë atë si një zonë të përshtatshme për të mbjellë vreshta ose ullinj. Një gjeograf/e ka një mënyrë unike të të vështruarit të saj. Pasi studion të gjitha mundësitë dhe kufizimet që ai/ajo ka, sugjeron zgjidhjet më të mira. Si i gjykon ti qëndrimet e secilit prej tyre ndaj mjedisit?"<br>Mësuesi/ja edhe mund të zgjerojë informacionin për të plotësuar të dhëna të tjera mbi situatën, psh. ai/ajo mund të detajojë qëndrimin e secilit individ mbi mjedisin nartyror të paraqitur në figurë: (shih shembullin përbri)<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë, vlerësojnë rolin e gjeografit/es<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: Në studimet e tyre, gjeografët përdorin mjete dhe burime të ndryshme, si për shembull:<br>burime parësore, dytësore. Gjatë trajtimit të saj, mësuesja fton nxënësit/et të shohin dhe të diskutojnë së bashku mbi skemën e librit (fig 16) dhe figurat (17/a e 17/b).<br>Nxënësit/et diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë burimet, mjetet dhe metodat e gjeografit/es.<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1dhe 2. Plotësohet skema 1 në fletoren e nxënësit. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.5 Pesë temat bazë të gjeografisë

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.5 Pesë temat bazë të gjeografisë** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi pesë temat bazë të gjeografisë, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Interpreton duke e ilustruar vendndodhjen gjeografike dhe vendin (nga pesë temat bazë të gjeografisë), me shembuj konkretë.<br>**3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)**<br>• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (harta, foto, revista ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e diskutimeve të shembujve të përdorur në klasë për të ilustruar vendndodhjen gjeografike dhe vendin.<br>• Parashtron pyetje (pse, çfarë, si?), organizon mendimet e veta dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.<br>**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.<br>**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***<br>• Ndan mendimet në grup.<br>**6. Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit/dikutimeve të grupit.<br>**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***<br>• Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. | | | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**<br>**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**<br>Nxënësi/ja përshkuan kuptimin dhe vëzhgon mbi pesë temat bazë të gjeografisë, veçanërisht mbi vendndodhjen gjeografike dhe vendin.<br>**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**<br>Nxënësi/ja vlerëson dhe komunikon me të tjerët rolin e pesë temave bazë të gjeografisë, në trajtimin e problemeve që bëhen objekt i gjeografisë.<br>**3. Marrja e vendimeve**<br>Nxënësi vlerëson rëndësinë e përcaktimit të vendndodhjes gjeografike dhe të tipareve që e karakterizojnë një vend. | | | |
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja demonstron përmes shembujve kuptimin mbi vendndodhjen gjeografike (absolute, relative të vendit) dhe vendin (tiparet fizike dhe humane). | | **Fjalët kyçe:** pesë temat bazë të gjeografisë, vendndodhja, vendi | |

<table>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, glob, harta fiziko gjeografike/politiko administrative të Shqipërisë, foto/materiale që paraqesin tipare fizike e humane të Shqipërisë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, biologji.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>a. Objektin e gjeografisë, degët dhe rolin e saj.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td>Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I: Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.5 në tekst- Diskutojmë: “Fton një mikun/të afërmin tënd që ndodhet jashtë Shqipërisë, për disa ditë pushimesh në shtëpinë tënde në Tiranë (ose në vendin ku jeton). Nëse ai e pranon ftesën, menjëherë kërkon të dijë se ku ndodhet ky vend. Si do ta orientoje, ti mikun/të afërmin tënd? Si do t’ia përshkruaje vendin tënd?”<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë...<br>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto<br>Mësuesi/ja vazhdon: Vendi që përshkruat, është objekt i studimit të gjeografisë. Ai është një nga “pesë temat bazë të gjeografisë”. Po çfarë janë “pesë temat bazë të gjeografisë?”. Shihni figurën 18. Skema tregon se cilat janë “pesë temat bazë të gjeografisë” dhe jep kuptimin e tyre.<br>Mësuesi/ja vazhdon: Vendi që përshkrove ka një vendodhje gjeografike. Ajo është absolute dhe relative....<br>Gjatë trajtimit, fton nxënësit/et të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembujt e përdorur në tekst (shembujt 1, 2)<br>Mësuesi/ja vazhdon: Cilat janë tiparet që ka një vend? Vendi ka tipare ....<br>Fton nxënësit/et të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembullin e përdorur në tekst (shembulli 3).</td><td>Përgjigjet e gjeografit mbi situatën në figurën 15.<br>Pasi e studion mjedisin natyror të paraqitur në figurën nr. 15, gjeografi ofron përgjigje për urbanistin dhe për fermerin. Për shkak të klimës dhe të relievit, ai e quan të përshtashme idenë e fermerit për vreshtari.<br>Për urbanistin ai sugjeron: nëse do të jetë një zonë turistike, për shkak të shtresave të paqëndrueshme dhe të rëshqitshme të tokës në të nuk mund të ketë ndërtime shumëkatëshe, por vetëm disa ndërtime të ulëta. Përveç kësaj, për të mbrojtur bregdetin dhe ujërat nga ndotjet, gjeografi kërkon që urbanisti të planifikojë drejt se ku do të derdhen ujërat e zeza dhe të bardha.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë vendndodhjen absolute, relative të vendit të tyre si dhe tiparet fizike dhe humane të tij.<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimin 4 te rubrika “Radha jote”: *Hulumto dhe diskuto mbi tematikën e paraqitur në* ***situatën 1****“Përmbytjet e vazhdueshme në veri por edhe në jug të Shqipërisë, konsiderohen si një dukuri katastrofike për jetën dhe ekonominë e banorëve, por edhe për zhvillimet e vendit tonë. Cilat janë shkaqet dhe si mund të zgjidhet kjo situatë?” Për këtë, përcakto: a) vendndodhjen gjeografike të vendeve që janë prekur më tepër nga përmbytjet; b) tiparet fizike dhe humane të këtyre vendeve.* |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/et fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.6 Rajoni

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.6 Rajoni** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi rajonin, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor mbi rajonin nga harta, libra, internet etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë disutimeve dhe detyrave në grup.

**2. Kompetenca e të menduarit (nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë midis konceptit vend dhe rajon.

**3. Kompetenca e të nxënit (nxënësi/ja mëson për të nxënë)**
- Ndërlidh temën e re me njohuritë e mëparshme.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave në grup.

**5. Kompetenca personale (*nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***
- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**
- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (*nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***
- Përdor mjetet digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me shoqet/kët.

<table>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi përshkuan lloje të ndryshme rajonesh.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi diskuton përmes shembujve veçoritë e rajoneve dhe hulumton informacion mbi to.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi diferencon rajonet gjeografike, kulturore, etj. Sjell shembuj të tjerë ilustrues nga vendi/Evropa.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja demonstron kuptimin mbi rajonin.</td><td>Fjalët kyçe: rajoni, rajone fizike, rajone kulturore, politike, ekonomike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, glob, harta fiziko gjeografike/politiko administrative të botës/Evropës/Shqipërisë, foto/materiale që paraqesin tipare fizike e humane të rajoneve të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, histori.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësitet dinë:<br>a. Pesë temat bazë të gjeografisë.<br>Nxënësit kanë hulumtuar mbi situatën 1 në ushtrimin 4 tek mësimi 1.5:<br>b. Hulumto dhe diskuto mbi tematikën e paraqitur në situatën 1“Përmbytjet e vazhdueshme në veri por edhe në jug të Shqipërisë, konsiderohen si një dukuri katastrofike për jetën dhe ekonominë e banorëve, por edhe për zhvillimet e vendit tonë. Cilat janë shkaqet dhe si mund të zgjidhet kjo situatë?” Për këtë, përcakto: a) vendndodhjen gjeografike të vendeve që janë prekur më tepër nga përmbytjet; b) tiparet fizike dhe humane të këtyre vendeve</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I: Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.6 në tekst- Diskutojmë: Risill në vemendje, situatën 1, për të cilën fillove hulumtimin në mësimin 1.5. Dallove që disa vende në Shqipëri edhe pse kanë vendndodhje të ndryshme, janë gjendur në të njëjtat situata përmbytjeje të vazhdueshme. Në hartën e Shqipërisë, për ti dalluar, mund ti ngjyrosës të gjitha këto vende edhe me të njëjtën ngjyrë. Bazuar në këtë situatë të ngjashme, a mund ti gruposh këto vende në një rajon të vetëm, si “zonat e përmbytura nga rreshjet e vitit...”<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë...</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: Pra edhe pse këto vende kanë venndodhje gjeografike të ndryshme, mund të grupohen në një rajon, sipas elementit që kanë të përbashkët (në këtë rast është situata e përmbytjeve).<br>Më tej vazhdon: Vende të ndryshme mund të kenë tipare të përbashkëta fizike ose humane. Bazuar në tiparet e ngjashme që mund të kenë, gjeografët i grupojnë vendet në rajone.<br><br>Për ta kuptuar konceptin rajon, mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë dhe të diskutojnë mbi shembullin 1 (një rajon fizik).<br>Nxënësit diskutojnë...<br>Mësuesi/ja vazhdon: Përveç rajoneve fizike, formohen edhe rajone kulturore, politike ....<br>Fton nxënësit të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembullin e përdorur në tekst (shembulli 2).<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë mbi rajonin kulturor...<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1, 2 tek rubrika “Radha jote” si dhe ushtrimin 4 tek fletorja e nxënësit. Lihet detyrë në grup, në shtëpi, ushtrimi 3 |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.7 Lëvizja

<table>
<tr><th>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</th><th>LËNDA: GJEOGRAFI</th><th>SHKALLA: III</th><th>KLASA: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik</td><td colspan="2">Tema mësimore: I.7 Lëvizja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi lëvizjen, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>• Veçon llojet e lëvizjeve dhe i komenton me moshatarët e tij/saj.<br>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)<br>• Përdor krahasimin dhe kontrastin për të dalluar llojet e lëvizjeve.<br>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)<br>• Ndërlidh temën e re me njohuritë e mëparshme.</td></tr>
</table>

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave në grup.

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi /japërkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mjetet digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me shoqet/kët.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja vëzhgon llojet e lëvizjeve dhe shkaqet e tyre.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi vlerëson rolin e zhvillimit të teknologjisë dhe të përdorimit të mjeteve e formave digjitale në njohjen mbi botën dhe në lëvizjen e mallrave ideve e informacionit. Dallon se dukuria e migrimeve të popullsisë ka ndodhur në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe për arsye të ndryshme.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja diferencon përmes shembujve nga vendi/Evropa/bota, llojet e ndryshme të lëvizjes.

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi demonstron kuptimin mbi lëvizjen. | **Fjalët kyçe:** lëvizje, migrim, eksport, import, lëvizje e ideve. |
| **Burimet:** Teksti, glob, harta fiziko gjeografike/ politiko administrative të botës/Evropës/ Shqipërisë, foto/materiale që paraqesin llojet e ndryshme të lëvizjeve. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, histori. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve**

| | |
|---|---|
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësit/et dinë:<br>a. Pesë temat bazë të gjeografisë.<br>Nxënësit/et njohin:<br>b. disa forma lëvizjesh (të njerëzve ose mallrave): |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.7 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I : Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.7 në tekst- Diskutojmë: Udhëtojmë nga një vend në tjetrin. Komunikojmë me njëri–tjetrin në mënyra të ndryshme, por edhe varemi nga produkte, informacione e ide që vijnë nga jashtë ambientit tonë. Të gjitha këto lëvizje bëhen objekt i studimit të gjeografëve. Sa lloje të komunikimit dalloni në jetën e përditshme?<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë... |

| | |
|---|---|
| | **Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja, është një tjetër temë bazë e gjeografisë që përfshin: lëvizjen e njerëzve, të mallrave, të informacionit dhe të ideve... Më tej vazhdon: lëvizja e njerëzve (migrimi): mund të bëhet për një jetë më të mirë, për më tepër liri, për arsye katastrofash natyrore, ...<br>Për ta kuptuar konceptin, mësuesi/ja fton nxënësit/et të krahasojnë figurat 25, 26 në tekst dhe të diskutojnë mbi shkaqet që kanë sjellë lëvizjet e popullsisë.<br>Nxënësit/et diskutojnë...<br>Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja e mallrave përfshin...<br>Fton nxënësit/et të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi figurën 27.<br>Nxënësit/et diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...<br>Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja e ideve përfshin...<br>Fton nxënësit/et të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi figurën 28.<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet tek rubrika “Radha jote”. Lihet detyrë në grup, në shtëpi, ushtrimi 5. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: I.8 Bashkëveprimi njeri-natyrë

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika I: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** | | **Tema mësimore: I.8 Bashkëveprimi njeri-natyrë** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi bashkëveprimin njeri-natyrë, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>• Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, harta të ndryshme etj.,e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të detyrës.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për diskutimin e bashkëveprimit midis njeriut dhe natyrës. | | | |

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët në funksion të mbrojtjes/përmirësimit të mjedisit.

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjet e dhëna, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

**7. Kompetenca digjitale (*Nxënës/jai përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja përshkuan se midis njeriut dhe natyrës ka pasur gjithmonë një raport bashkëveprues.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja vlerëson rolin e bashëveprimit njeri-natyrë.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja mban qëndrim kritik ndaj rasteve të ndikimit negativ të njeriut mbi natyrën dhe mbështet format e ndikimit pozitv mbi të.

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja demonstron konceptin bashkëve-prim dhe përmes shembujve analizon dhe vlerëson format e bashkëveprimit midis nje-riut dhe natyrës. | **Fjalët kyçe:** bashkëveprimi njeri-natyrë. |
| **Burimet:** Teksti, foto/materiale që paraqesin bashkëveprimin e njeriut me natyrën. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, histori, biologji, qytetari. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve**

| | |
|---|---|
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nx-ënësve*** | Nxënësit dinë:<br>a. Pesë temat bazë të gjeografisë.<br>Nxënësit kanë shembuj:<br>b. të lidhjes së njeriut me natyrën. |
| ***b. Ndërtimi i njohu-rive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). |

| | |
|---|---|
| | **Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.8 në tekst- Diskutojmë: Risill përsëri në vemendje, situatën 1 në mësimin 1.5, me vendet që kanë pësuar vazhdimisht përmbytje. Diskuto në klasë:  A është veprimtaria e njeriut një prej faktorëve që ndikojnë në mjedis?<br>Nxënësit diskutojnë, tregojnë se lëvizja e njerëzve pa kriter dhe vendosja e shtëpive dhe e aktivitetit ekonomik të tyre pranë shtretërve të lumenjve, është një prej faktorëve që ka ndikuar në mjedis. Një tjetër faktor është gërryerja që i bëjmë lumenjve për të përfituar lëndë të parë për ndërtim etj.<br>**Hapi II:  Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: Njeriu dhe mjedisi bashkëveprojnë midis tyre dhe si rezultat, për të dy rrjedhin pasoja e përfitime. Më tej vazhdon: si ndikojmë ne mjedisin e si ndikon ai mbi ne.<br>Për ta kuptuar konceptin bashkëveprim, mësuesi/ja në çdo moment fton nxënësit të krahasojnë figurat 29, 30 dhe 31 në tekst dhe të diskutojnë mbi format e bashkëveprimit.<br>Nxënësit/et diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup raste të ngjashme nga jeta e tyre mbi ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut mbi natyrën. Diskutojnë gjithashtu edhe ushtrimet tek rubrika "Radha jote" Punohet ushtrimi 5 dhe 6 në fletoren e nxënësit. Lihet detyrë në grup, në shtëpi, ushtrimi 5 si dhe skema 2 në fletoren e nxënësit. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

## Përsëritje1 (model) Tema: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik

1. Bashkangjitur tekstit, është vënë edhe fletorja e punës së nxënësit. Në të jepen variante të ndryshme ushtrimesh, të ndara në rubrika (të cilat përfaqësojnë edhe llojet e kompetencave që do të fitojë nxënësi). Mësuesi/ja është i/e lirë të përzgjedhë midis ushtrimeve të paraqitura. Ai/Ajo e orienton nxënësin që të punojnë në mënyrë të pavarur në fletoren e punës. Në përfundim, mësuesi/ja kontrollon zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në fletoren e punës, i bën pjesë të diskutimit në klasë. Nxënësit i bëjnë ato pjesë të portofoleve të tyre.
2. Mësuesi/ja është i/e lirë të përzgjedhë midis ushtrimeve të paraqitura, për ti bërë ato pjesë të **testit I** që do të hartojë, në fund të tremujorit të parë (shih planin vjetor dhe 3-mujorin e parë).

3. Mësuesi/ja është i/e lirë të realizojnë përsëritjen sipas nevojave. Ai/Ajo mund ta zhvendosë atë në varësi të kërkesave dhe të nivelit të nxënësve (mund ta bëjë në fund të nëntematikës së parë ose përpara **testimit I** në fund 3-mujorin e parë).

**Testim 1 Tema: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik** (shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të parë për orën se kur bëhet testimi)

Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipet ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit dhe të fletores së punës të nxënësit).

- ***Shënim:*** Në orën e përsëritje dhe të testimit, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi/ja duhet të vlerësohet për shkallën e përceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit për ti shpjeguar ato me fjalët e tij, por sidomos në aftësinë për ti zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues te nxënësit.

# Nëntematika II: Hartat gjeografike

## Tema mësimore: 2.1 Paraqitja grafike e Tokës

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika II: Hartat gjeografike** | | **Tema mësimore: 2.1 Paraqitja grafike e Tokës** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**<br>• Shpreh mendimin e vet mbi mënyrën e paraqitjes grafike të Tokës.<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis globit, hartës, planit.<br>**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**<br>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi globin, hartën, planin, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup, mbi situatën e dhënë në tekst (për vëllanë/motrën studente...). | | | |

| | |
|---|---|
| **5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)*<br>• Ndan mendimet në grup.<br>**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.<br>**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht. | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**<br>**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**<br>Nxënësi/ja përshkuan informacionin që ofron globi,harta, plani.<br>**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e tyre në sigurimin e informacioneve mbi botën që na rrethon.<br>**3. Marrja e vendimeve**<br>Nxënësi /jadiskuton mbi të përbashkëtat dhe dallimet midis globit, hartës dhe planit, duke vlerësuar rolin e tyre në njohjen e botës. | |
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja krahason globin, hartën dhe planin, duke treguar të përbashkëtat dhe dallimet mid-is tyre. | **Fjalët kyçe:** globi, harta, plani. |
| **Burimet:** Teksti, glob, harta politiko administrative të botës/Evropës/Italisë/Romës, foto që paraqesin llojet të ndryshme hartash/planesh. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematika. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nx-ënësve*** | Nxënësit kanë njohuri mbi:<br>a. formën e në globi dhe kanë parë harta të ndryshme, të cilat janë përdorur gjatë nëntematikës së parë.<br>b. faktin që vende të ndryshme kanë vendodhje geografike të ndryshme. |
| ***b. Ndërtimi i njohu-rive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartën politike të Evropës, hartën politiko-administrative të Italisë, të Romës, planin e Universitetit La Sapienza (të printuar nga interneti). Në mungesë të ndonjërës prej tyre, i orienton nxënësit të shohin figurat 2,3,4,5 në tekst. Përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.1 në tekst – "Diskutojmë: Vëllai/motra jote, student i drejtësisë do të shkojë në një seminar të organizuar nga Universiteti "La Sapienza" Romë. Atij/asaj i duhet informacion mbi: vendndodhjen e universitetit, planimetrinë e tij, distancën e universitetit me objekte të njohura prej tij, rrugët që të çojnë në këtë universitet etj. Për të grumbulluar informacionin e nevojshëm, fillimisht, ti për ta ndihmuar, mund ti drejtohesh globit, hartës së Italisë/Romës dhe planit të zonës ku |

| | |
|---|---|
| | ndodhet universiteti, pasi ato janë tre forma të paraqitjes grafike të sipërfaqes së Tokës. Çfarë informacioni mund të ofrojnë secila prej tyre?"<br>Fton nxënësit të diskutojnë se çfarë informacioni i ofron secila prej tyre.<br>Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja thekson edhe njëherë një detaj të paraqitur në situatën e vendosur në fillim të mësimit: Pse duhet ti drejtohesh këtyre të triave? Sepse globi, harta dhe plani janë tre format e paraqitjes grafike të sipërfaqes së Tokës.<br>Më tej vazhdon dhe sqaron konceptin mbi secilën prej tyre (ç'është globi, harta dhe plani), duke i orientuar vazhdimisht nxënësit që atë që trajtohet ta shohë konkretisht në globin dhe në hartat e ekspozuara (ose në figurat e tekstit).<br>Ftohen nxënësit të gjejnë situata të ngjashme. I lihet si detyrë të gjejnë se çfarë të përbashkëta dhe çfarë ndryshime vunë re midis globit, hartës dhe planit.<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup. Lihet detyrë në shtëpi ushtrimet tek rubrika "Radha jote" dhe nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi/et i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 2.2 Përmbajtja e hartës

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika II: Hartat gjeografike** | | **Tema mësimore: 2.2 Përmbajtja e hartës** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth elementëve që mund të përmbajnë hartat e ndryshme,duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (elementë gjeografië dhe matematikorë), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Interpreton përmbajtejen e hartave të ndryshme, duke e ilustruar me shembuj konkretë.<br>**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**<br>• Përdor harta të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve (elementë gjeografië dhe matematikorë)), duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit. | | | |

<table>
<tr><td colspan="2">

• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.<br>
**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***<br>
• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.<br>
**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***<br>
• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.<br>
**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**<br>
• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.<br>
**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***<br>
• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.
</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**<br>
**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**<br>
Nxënësi/ja dallon dhe përshkuan elementet matematikore dhe gjeografike të hartës.<br>
**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**<br>
Nxënësi/ja vlerëson rolin e hartografisë në paraqitjen në mënyrë grafike të sipërfaqes së tokës.<br>
**3. Marrja e vendimeve**<br>
Nxënësi/ja diferencon elemente matematikore dhe gjeografike të hartave (në harta të ndryshme shkollore dhe në harta të siguruara elektronikisht).
</td></tr>
<tr><td>

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore**: Nxënësi/ja, dallon elementët që përmbajnë hartat e ndryshme gjeografike dhe vlerëson përdorimin e hartave në jetën e përditshme.
</td><td>

**Fjalët kyçe:** elemente matematikore, elemente gjeografike të hartës.
</td></tr>
<tr><td>

**Burimet:** Teksti, glob, harta fiziko-gjeografike, politiko administrative të botës/Evropës/Shqipërisë, harta të popullsisë etj.
</td><td>

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë.
</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve**
</td></tr>
<tr><td>

***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
</td><td>

Nxënësit dinë:<br>
a. Konceptin mbi hartat;<br>
b. Elemente të ndryshme që mund të përmbajnë hartat.
</td></tr>
<tr><td>

***b. Ndërtimi i njohurive të reja***
</td><td>

**Situata e të vepruarit**<br>
Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>
**Veprimet në situatë**<br>
**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>
Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat politike të botës/Evropës/Shqipërisë, hartat fiziko gjeografike të botës/Evropës/Shqipërisë. Fton nxënësit të shohin figurat 6, 7 në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.2 në tekst – "Diskutojmë: Përshkruaj përmbajtjen e hartave në figurat 6 dhe 7. Çfarë ngjashmëri dhe ndryshimeve dallon në to?"<br>
Nxënësit/et të diskutojnë se çfarë informacioni i ofron secila prej tyre...
</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesi/ja vazhdon: gjithë informacioni që përmbajnë hartat e mësipërme, apo çdo lloj harte tjetër, paraqitet me anë të elementeve të saj. Ato mund të jenë: elemente... Gjatë trajtimit të tyre, mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin dhe të përshkruajnë përmbajtjen e figurës 8 në tekst për të kuptuar se çfarë janë elementët matematikorë dhe ata gjeografikë të hartave.<br>Ftohen nxënësit/et në situata të ngjashme përmes hartave të ekspozuara në klasë. Gjejnë dhe përshkruajnë përmbajtjen e tyre (elementët matematikorë dhe gjeografikë) dhe vlerësojnë përdorimin e hartave. Sëbashku me nxënësit/et, mësuesi/ja vlerëson se për çfarë shërbjnë hartat.<br><br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Lihet detyrë ushtrimi 1.c) Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup. Lihet detyrë në shtëpi: ushtrimet 1.a) e 1.b) te rubrika “Radha jote” dhe nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 2.3 Rrjeta gjeografike

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika II: Hartat gjeografike** | | **Tema mësimore: 2.3 Rrjeta gjeografike** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe** | | | |

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi rrjetën gjeografike.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Demonstron dhe shpjegon për moshatarët e tij, globin me rrjetën gjeografike të ndërtuar prej tij.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake (topin me rrjetën gjeografike)

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/disutimi të situatës.

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup..

<table>
<tr><td colspan="3">6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.<br>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor/ja teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë (harta të ndryshme) elektronikisht.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja përshkuan kuptimin mbi rrjetën gjeografike (meridianët, paralelet, ekuatorin, Meridianin e Grinuiçit, Meridianin $180^0$).<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e përdorimit të tyre.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja diferencon meridianin fillestar, meridianin $180^0$ dhe ekuatorin për të përcaktuar hemisferat dhe largësitë në gradë të pikave të ndryshme në glob.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja, dallon dhe gjen në glob dhe në hartë: meridianë, paralele, polet gjeografike, ekuator, meridianin i Grinuiçit, meridianin $180^0$, hemisferën veriore, jugore, lindore, perëndimore.</td><td>Fjalët kyçe: meridianë, paralele, pole gjeografike, ekuator, meridiani i Grinuiçit, meridianin $180^0$, hemisfera veriore, jugore, lindore, perëndimore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, glob, harta të ndryshme ku jepet rrjeti koordinativ.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>c. Çfarë informacioni mund të përmbajë një glob dhe një hartë;<br>d. Elementet që përmbajnë hartat.<br>Nxënësit/et kanë ndërtuar vetë një rrjet koordinativ në punën praktike 2.1 dhe kanë krijuar një ide mbi të.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I : Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat e ndryshme të botës/Evropës/Shqipërisë. Fton nxënësit/set të shohin figurën 11 në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.3 (në tekst) – “Diskutojmë: Vërej globin e ekspozuar në klasë. Risill në vëmendje rrjetën e krijuar prej teje në një top llastiku (gjatë punës praktike 2.1) dhe përshkruaj se si e qarkon globin, rrjeta me vija imagjinare”.<br>Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Duke marrë si shembull figurat 12a/ dhe 12/b, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë sëbashku me nxënësit/et : kuptimin mbi paralelet dhe meridianët.<br>Bazuar në veprimtarinë e punës praktike 2.1, ftohen nxënësit/et të tregojnë:<br>a. çfarë janë paralelet e meridianët;<br>b. të përcaktojnë se nga ndyshojnë ato midis tyre;<br>c. për çfarë shërbejnë paralelet e meridianët.<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Bazuar në rubrikën "Radha jote" ftohen nxënësit/et të ushtrohen me ushtrimet e rubrikës dhe të diskutojnë mbi to.<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup . Lihet detyrë në shtëpi: ushtrime nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 2.4 Koordinatat gjeografike

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika II: Hartat gjeografike** | | **Tema mësimore: 2.4 Koordinatat gjeografike** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe** | | | |
| **1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)**<br>Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë kuptimin mbi gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike.<br>**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**<br>• Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.<br>**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve dhe aplikimit të modeleve ilustruese.<br>**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***<br>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup. | | | |

<table>
<tr><td colspan="3">6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.<br>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Përdor metet digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi dallon kuptimin mbi gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e koordinatave gjeografike në përcaktimin e saktë të vendndodhjes së vendeve të ndryshëm.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja, dallon dhe gjen në glob dhe në hartë: gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike të vendeve. Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.</td><td>Fjalët kyçe: gjerësi gjeografike, gjatësi gjeografike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, glob, harta të ndryshme ku jepet rrjeti koordinativ.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>a. Kuptimin dhe se për çfarë shërbejnë meridianët dhe paralelet;<br>b. Çdo vend ka një vendndodhje gjeografike të përcaktuar.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I : Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat e ndryshme të botës/ Evropës/Shqipërisë. Fton nxënësit/et të shohin figurën 14 në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.4 (në tekst) – “Diskutojmë: Risill në vëmendje vendndodhjen absolute të vendeve. Cili ishte kuptimi mbi vendndodhjen absolute? Cila ishte vendndodhja absolute e Tiranës? ”<br>Nxënësit/et diskutojnë se si vepruan për përcaktimin e vendndodhjes absolute të Tiranës dhe të vendbanimit të tyre, në mësimin 1.5.<br>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto<br>Duke marrë edhe si shembull figurat 14a/ dhe 14/b në tekst, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë sëbashku me nxënësit/et: kuptimin mbi gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike. Gjerësia gjeografie është... Gjatësia gjeografie është...</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Mësuesja/si thekson se koordinatat gjeografike të çdo vendi janë gjerësia dhe gjatësia gjeografike. Çdo vend ka një gjerësi dhe gjatësi gjeografike të përcaktuar që është e pandryshuar në çdo hartë e glob.**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup** Bazuar në rubrikën "Radha jote" ftohen nxënësit/et të ushtrohen me ushtrimet e rubrikës dhe të diskutojnë mbi to.<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup. Lihet detyrë në shtëpi: ushtrime nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 2.5 Shkalla e hartës

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika II: Hartat gjeografike** | | **Tema mësimore: 2.5 Shkalla e hartës** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi /jakomunikon në mënyrë efektive)**<br>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi shkallën e hartës.<br>**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**<br>• Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë, përdorimin e shkallës së zvogëlimit në harta.<br>**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**<br>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në tekstin shkollor për të llogaritur shkallën e hartës.<br>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.<br>**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë temë.<br>**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***<br>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.<br>**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.<br>**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht. | | | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**<br>**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**<br>Nxënësi/ja përshkuan mënyrat e paraqitjes së shkallës së zvogëlimit në harta të ndryshme.<br>**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e shkallës së zvogëlimit në sasinë e elementëve që përmban në hartë. | | | |

<table>
<tr><td colspan="3">3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja përdor shkallën e zvogëlimit të hartës për tu orientuar në terren me distancat reale.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi gjen në hartë dhe përdor shkallën numerike dhe grafike (lineare) të saj për tu orientuar në terren me distancat reale.</td><td>Fjalët kyçe: shkallë numerike, shkallë grafike, legjenda e hartës, simbole.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, glob, harta me shkallë të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit/et dinë:<br>a. Çfarë janë hartat dhe përse shërbejnë;<br>b. Cilët janë dhe përse shërbejnë elementët matematikorë të hartave.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I : Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat e ndryshme të botës/ Evropës/Shqipërisë. Fton nxënësit/et të shohin figurën 18 në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.5 (në tekst) – “Diskutojmë: Në hartat e figurës 17/a deri në atë 17/d, informacioni për objektet e ndodhura në bllokun numër 2 të banesave rritet. Përshkruaj se çfarë objektesh dallon në bllokun numër 2 të banesave në secilën prej hartave të figurës 17. Cila mund të jetë arsyeja e rritjes së informacionit mbi objektet e ndodhura në bllokun numër 2”.<br>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë<br>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto<br>Duke përdorur hartat e ekspozuara në klasë dhe hartën e figurës 19, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë sëbashku me nxënësit/et: kuptimin mbi shkallën e hartës dhe mënyrën e paraqitjes së saj në hartë.<br>Orientohen nxënësit se si të punojnë me shkallën e zvogëlimit në hartë, kjo edhe duke u bazuar tek figurat 18,19. Bazuar në to, nxënësit/et diskutojnë, krahasojnë...<br>Mësuesi/ja vazhdon: Çfarë elementësh përmbajnë hartat e ekspozuara? Me çfarë simbole paraqiten? Dini ju ç’janë simbolet? Vazhdon të përfshijë në diskutim nxënësit/et, duke i orientuar ata të përshruajnë përmbajtjen e hartave dhe legjendën e tyre....<br>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup<br>Bazuar në rubrikën “Radha jote” ftohen nxënësit/et të ushtrohen me ushtrimet e rubrikës dhe të diskutojnë mbi to.<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ... Lihet detyrë në shtëpi: ushtrime nga fletorja e punës.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 2.6 Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre

<table>
<tr><th>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</th><th>LËNDA: GJEOGRAFI</th><th>SHKALLA: III</th><th>KLASA: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika II: Hartat gjeografike</td><td colspan="2">Tema mësimore: 2.6 Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)<br>• Shpreh mendimin e vet për llojet e hartave dhe klasifikimin e tyre me gojë ose me shkrim.<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth llojeve të hartave.<br>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)<br>• Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.<br>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)<br>• Ndërlidh temën e re me përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme, sipas një radhitjeje logjike.<br>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e veprimtarive/detyrave në grup.<br>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)<br>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.<br>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.<br>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Përdor mediat digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja hulumton në rrugë eletronike harta të ndryshme që ndryshojnë sipas përmbajtjes, shkallës, përdorimit.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja vlerëson rolin e tyre në paraqitjen sa më reale të sipërfaqes së tokës.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja diferencon hartat sipas përmbajtjes, shkallës dhe përdorimit.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore**: Nxënësi, dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre. Përdor TIK-un për gjetjen e hartave të ndryshme në rrugë elektronike. | **Fjalët kyçe:** Harta sipas përmbajtjes, sipas shkallës, sipas përdorimit. |
| **Burimet:** Teksti, harta të ndryshme (të ekspozuara në klasë dhe të siguruara e të printuara nga interneti) që ndryshojnë sipas përmbajtjes, shkallës së zvogëlimit dhe përdorimit. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësit/et dinë:<br>a. Çfarë janë hartat dhe përse shërbejnë;<br>b. Cilët janë dhe përse shërbejnë elementët gjeografikë të hartave. |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I : Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat e ndryshme të botës/ Evropës/Shqipërisë/Kosovës etj. Fton nxënësit/et të shohin figurën 21 (a/b/c/d) në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.6 (në tekst) – “Diskutojmë: Tri hartat: a,b,c, të paraqitura në figurën 21, paraqesin Republikën e Kosovës. Po t’i shihni me kujdes, ato kanë ndryshime midis tyre, edhe pse kanë të njëjtën shkallë zvogëlimi. Pse? ”<br>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Duke përdorur hartat e ekspozuara në klasë dhe hartën e figurave 21, 22 dhe skemën e figurës 23, mësuesi/ja vazhdon të evidentojë sëbashku me nxënësit/et, llojet e hartave sipas përmbajtjes.<br>Bazuar në to, nxënësit diskutojnë... krahasojnë...<br>Orientohen përsëri nxënësit të krahasojnë midis tyre elementët që përdoren për të paraqitur relievin në hartat 21/a e 22 dhe të përcaktojnë ndryshimin midis tyre.<br>Bazuar në to, nxënësit/et diskutojnë, krahasojnë...<br>Mësuesi/ja vazhdon: Çfarë elementësh përmbajnë hartat e ekspozuara? Me çfarë simbole paraqiten? Dini ju ç’janë simbolet? Vazhdon të përfshijë në diskutim nxënësit, duke i orientuar ata të përshruajnë përmbajtjen e hartave dhe legjendën e tyre....<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Orientohen nxënësit/et të krahasojnë midis tyre elementët që përdoren për të paraqitur relievin në hartat e ekspozuara në klasë dhe të përcaktojnë ndryshimin midis tyre (për nga elementët që përdorin në pasqyrimin e sipërfaqes së tokës). |

| | |
|---|---|
| | Bazuar në rubrikën "Radha jote" ftohen nxënësit/et të ushtrohen me ushtrimet e rubrikës 1, 2, 3, 4 dhe të diskutojnë mbi to.<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup. Lihet detyrë në shtëpi: ushtrimi 5 dhe ushtrime nga fletorja e punës ushtrimi 3, 4,5 si dhe skema përmbullëse.. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Përsëritje. 2 (model) Tema: Hartat gjeografike

Bashkangjitur tekstit, është vënë edhe fletorja e punës së nxënësit/set. Në të jepen variante të ndryshme ushtrimesh, të ndara në rubrika (të cilat përfaqësojnë edhe llojet e kompetencave që do të fitojë nxënësi). Mësuesi/ja është i/e lirë të përzgjedhë midis ushtrimeve të paraqitura. Ai/Ajo e orienton nxënësin/en që të punojnë në mënyrë të pavarur në fletoren e punës. Në përfundim, mësuesi/ja kontrollon zgjidhjet e dhëna nga nxënësit në fletoren e punës, i bën pjesë të diskutimit në klasë. Nxënësit i bëjnë ato pjesë të portofoleve të tyre.

1. Mësuesi/ja është i/e lirë të përzgjedhë midis ushtrimeve të paraqitura, për ti bërë ato pjesë të **testit II** që do të hartojë, në fund të tremujorit të parë (shih planin vjetor dhe 3-mujorin e parë).

2. Mësuesi/ja është i/e lirë të realizojnë përsëritjen sipas nevojave. Ai/Ajo mund ta zhvendosë atë në varësi të kërkesave dhe të nivelit të nxënësve (mund ta bëjë në fund të nëntematikës së dytë ose përpara **testimit II** në fund 3-mujorin e dytë).

**Testim. 2 Tema: Hartat gjeografike** (shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të dytë për orën se kur bëhet testimi)

Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit/set: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipet ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit dhe të fletores së punës të nxënësit/es).

- ***Shënim:*** Në orën e përsëritjes dhe të testimit, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi duhet të vlerësohet për shkallën e përceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve

të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit/et për ti shpjeguar ato me fjalët e tij, por sidomos në aftësinë për ti zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues te nxënësit/es.

# Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal

Kjo nëntematikë është specifike në mënyrën e trajtimit në tekst. Është konceptuar në këtë formë: në hyrje të çdo teme mësimore (e cila trajton një aspekt të caktuar të vendbanimit ku jeton nxënësi/ja) jepen disa të dhëna të rëndësishme për vendin tonë, Shqipërinë (si vendbanimi i madh i përbashkët për të gjithë) dhe më pas kjo mënyrë të trajtuari duhet të shërbejë si bazë për trajtimin e informacionit mbi vendbanimin e nxënësve. Mësuesi/ja i ofron nxënësve një informacion bazë mbi vendbanimin dhe më pas i udhëzon ata të hulumtojnë, vëzhgojnë më tej dhe të prezantojnë vendbanimin e tyre. Pra, përmes informacioneve që ofrohen për Shqipërinë, nxënësi/ja ka një model për të organizuar punën dhe për të ndërtuar informacionin mbi vendin ku jeton (shih skemën e mëposhtme).



# Tema mësimore: 3.1 Vendndodhja gjeografike e vendbanimit tonë

<table>
<tr><th>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</th><th>LËNDA: GJEOGRAFI</th><th>SHKALLA: III</th><th>KLASA: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal</td><td colspan="2">Tema mësimore: 3.1 Vendndodhja gjeografike e vendbanimit tonë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)<br>• Shpreh mendimin e vet mbi vendndodhja gjeografike e vendbanimit<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi vendndodhjan gjeografike të vendbanimit duke bërë pyetje dhe komente.<br>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)<br>• Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë vendndodhjen gjeografike të vendbanimit të tij.<br>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)<br>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e vendndodhjes gjeografike të vendbanimit, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.<br>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)<br>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e veprimtarive/vëzhvimit/hulumtimit mbi vendbanimin e vet.<br>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)<br>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.<br>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>• Tregon vetëbesim të lartë në përfundimet e arritura prej tij dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së përfundimeve të grupit.<br>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja përshkuan vendodhjen gjeografike të Shqipërisë (absolute dhe relative).<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja mbledh informacion mbi vendndodhjen gjeografike të vendbanimit të vet (qyteti/fshati).<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja përcakton në hartë e në glob vendndodhjen absolute të vendit të vet (qyteti/fshati) dhe përshkruan vendndodhjen relative të tij.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi interpreton në hartë vendndodhjen e zonës (qytetit/fshatit) ku banon.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: vendndodhja gjeografike e vendit tim (qytetit/fshatit).</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Burimet:** Teksti, harta të ndryshme të Shqipërisë (të ekspozuara në klasë dhe të siguruara e të printuara nga interneti), pamje të ndryshme nga vendbanimi. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, shkenca natyrore. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësit/et dinë:<br>a. Gjeografia e shtrin studimin e saj nga mjedisi më i afërt (lokal) tek ai më i madh (në këtë rast Shqipëria);<br>b. Çfarë janë koordinatat gjeografike dhe si përcaktohen koordinatat gjeografike të vendit ku jeton. |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj) dhe të dhënat që jepen për Shqipërinë.<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin e hartën e Shqipërisë dhe fton nxënësit/set të diskutojnë mbi situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.1 (në tekst) – "Diskutojmë: Secili prej nesh, jeton në një qytet apo në një fshat të Shqipërisë. Sipas vendit ku kemi lindur e jetojmë, themi, p.sh. jam nga Tirana, Durrësi, Shkodra, Berati, Kukësi, Elbasani, Gjirokastra, Korça, etj. Pavarësisht se nga cili qytet apo fshat jemi, Shqipëria është vendbanimi ynë i madh i përbashkët. Ku ndodhet Shqipëria?".<br>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë.<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesja fton nxënësit/et të shohin hartën në figurën 1, çështjen e trajtuar në tekst mbi vendndodhjen gjeografike të Shqipërisë dhe të përcaktimin e venndodhjes absolute e relative të disa prej qyteteve të Shqipërisë.<br>Diskuton me ta mbi informacionin e dhënë.<br>Më pas mësuesi/ja u jep nxënësve me shënime (të printuara) të dhëna mbi vendndodhjen gjeografike të vendbanimit të tyre.<br>Bazuar në to, nxënësit/et diskutojnë, krahasojnë me të dhënat etyre<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Orientohen nxënësit të hulumtojnë, vëzhgojnë dhe të prezantojnë mbi vendbanimin e tyre.<br>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ... Plotësohet rubrika "Radha jote" dhe nxënësitset të diskutojnë mbi to.<br>Lihet detyrë në shtëpi: ushtrimin 1 nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/ses fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 3.2 Tiparet e relievit në vendbanimin tonë

<table>
<tr><th>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</th><th>LËNDA: GJEOGRAFI</th><th>SHKALLA: III</th><th>KLASA: VI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal</td><td colspan="2">Tema mësimore: 3.2 Tiparet e relievit në vendbanimit tonë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe<br>
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)<br>
• Përshkruan qartë dhe saktë, tiparet e relievit të vendbanimit të tij/saj.<br>
• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tipareve të relievit të vendbanimit të tij/saj, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.<br>
2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)<br>
• Interpreton në hartë, hulumton dhe ndërton indormacionin e duhur (duke e ilustruar me shembuj konkretë) mbi tiparet e relievit në vendbanimin e tij/saj.<br>
3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)<br>
• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti, mësuesja internet, media, për të nxënë.<br>
• Ndërlidh temën e re me njohuritë, përvojat paraprake, informacionet e dhëna nga mësuesja, të marra nga pushteti vendor apo gjatë hulumtimeve e vëzhgimeve, mbi tiparet e relievit në vendbanimin e tij/saj.<br>
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)<br>
• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti /hulumtimi në bazë grupi).<br>
5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)<br>
• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.<br>
6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)<br>
• Tregon vetëbesim të lartë në përfundimet e nxjerra prej tij dhe kontribuon përmes tyre në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.<br>
7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>
• Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.<br>
• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>
1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>
Nxënësi/ja hulumton dhe vëzhgon përbërësit kryesorë të relievit në vendbanimin e tij.<br>
2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>
Nxënësi/ja përcjell informacion midis anëtarëve të grupit mbi veçoritë kryesorë të relievit në vendbanimin e tij.<br>
3. Marrja e vendimeve<br>
Nxënësi/ja përcakton tiparet kryesorë të relievit dhe pasuritë nëntokësore (por edhe lëndët e para të materialeve të ndërtimit etj) të vendbanimit të tij.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore**: Nxënësi/ja përshkruan përbërësit kryesorë të relievit duke dalluar elementë të veçantë. | **Fjalët kyçe:** reliev, shkëmbinj të shumëllojshëm. |
| **Burimet:** Teksti, harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë (e ekspozuar në klasë dhe e siguruar nga interneti - e të printuar), pamje të ndryshme nga relievi në vendbanimin e tij. Diskuton mbi rrugët nëpërmjet të cilave njerëzit kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore (p.sh., përdorimi i gurëve, rërës, etj). | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, histori. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve** | |
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësitset dinë:<br>a. Koordinatat gjeografike të vendit ku jeton.<br>b. Cilat janë disa tipare fizike të Shqipërisë (shembulli 3 në temën mësimore 1.5) dhe të vendbanimit të tyre. |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj) dhe të dhënat që jepen për Shqipërinë.<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë hartën e Shqipërisë dhe fton nxënësit/et të diskutojnë mbi situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.2 (në tekst) – "Diskutojmë: Pozita gjeografike që ka Shqipëria, ka ndikuar shumë në tiparet fizikogjeografike të saj. Falë kësaj pozite gjeografike, në Shqipëri ka reliev dhe përbërje shkëmbore të larmishme, pasuri minerale, ka shumë pasuri ujore, një klimë të përshtatshme për jetesë, toka pjellore, botë të gjallë të shumëllojshme, etj. Cilat janë tiparet kryesore të relievit të Shqipërisë. Po në vendbanimin tuaj?<br>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë mbi zonat që kanë parë në Shqipëri (nga emisione të ndryshme televizive, nga media, revista etj) dhe në vendbanimin e tyre.<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesja fton nxënësit/et të shohin hartën në figurën 2 dhe të njihen me tiparet kryesore të relievit të Shqipërisë dhe me përbërja e truallit të saj.<br>Diskuton me ta mbi informacionin e dhënë.<br>Më pas mësuesi/ja u jep nxënësve me shënime (të printuara) të dhëna mbi tiparet kryesore të relievit dhe me përbërjen e truallit të vendbanimit të tyre.<br>Bazuar në to, nxënësit diskutojnë, krahasojnë, vlerësojnë relievin.<br>Më pas orientohen nxënësit/et të punojnë me ushtrimin 1/a, 3, 4 në tekst dhe të diskutojnë mbi to. |

| | |
|---|---|
| | **Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Orientohen nxënësit/et të hulumtojnë, vëzhgojnë dhe të prezantojnë mbi vendbanimin e tyre.<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup Plotësohen kërkesat 1/b/c/d/e dhe 2 te rubrika "Radha jote" dhe nxënësit/et dhe të diskutojnë mbi to.<br>Lihet detyrë në shtëpi: ushtrimin 2 nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/ses fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 3.3 Pasuria ujore në vendbanimin tonë

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal** | | **Tema mësimore: 3.3 Pasuria ujore në vendbanimin tonë** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Përshkruan qartë dhe saktë, pasurinë ujore të vendbanimit të tij/saj.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth pasurisë ujoretë vendbanimit të tij/saj, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Interpreton në hartë, hulumton dhe ndërton indormacionin e duhur (duke e ilustruar me shembuj konkretë) mbi pasurinë ujore në vendbanimin e tij/saj.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti, mësuesja internet, media, për të nxënë.
- Ndërlidh temën e re me njohuritë, përvojat paraprake, informacionet e dhëna nga mësuesja, të marra nga pushteti vendor apo gjatë hulumtimeve e vëzhgimeve, mbi tiparet e pasurisë ujore në vendbanimin e tij/saj.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti /hulumtimi në bazë grupi).

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi /japërkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Tregon vetëbesim të lartë në përfundimet e nxjerra prej tij dhe kontribuon përmes tyre në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

<table>
<tr><td colspan="3">7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)<br>• Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.<br>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja hulumton dhe vëzhgon përbërësit kryesorë të pasurisë ujore në vendbanimin e tij/saj.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja përcjell informacion midis anëtarëve të grupit mbi veçoritë kryesorë të pasurisë ujore në vendbanimin e tij/saj.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi/ja përcakton dhe vlerëson tiparet kryesorë të pasurisë ujore në vendbanimit të tij në favor të zhvillimit ekonomik të zonës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja përshkruan burimet ujore (burime, lumenj, liqene, dete etj.), duke dalluar elementë të veçantë.</td><td>Fjalët kyçe: burime, lumenj, liqene, dete.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti, harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë (e ekspozuar në klasë dhe e siguruar nga interneti - e të printuar), pamje të ndryshme nga pasuria ujore e vendbanimit. Vëzhgon dhe sjell shembuj si kanë ndikuar këto burime në jetën e banorëve;</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, biologji.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</td><td colspan="2">Nxënësit dinë:<br>a. Cilat janë disa tipare fizike të Shqipërisë (shembulli 3 në temën mësimore 1.5);<br>b. Informacione të ndryshme mbi pasurinë ujore të Shqipërisë dhe të vendbanimit të tyre.</td></tr>
<tr><td>b. Ndërtimi i njohurive të reja</td><td colspan="2">Situata e të vepruarit<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj) dhe të dhënat që jepen për Shqipërinë.<br>Veprimet në situatë<br>Hapi I : Rrjeti i diskutimit<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë hartën e Shqipërisë dhe fton nxënësit/et të diskutojnë mbi situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.3 (në tekst) – “Diskutojmë: Shqipëria është tepër e pasur në ujëra. Ajo ka dalje në Mesdhe, ka shumë liqene natyrore dhe artificiale, lumenj, ujëra nëntokësore dhe burime të shumta. Kjo pasuri ujore ka rëndësi të madhe jetësore dhe ekonomike. Ka rëndësi sepse ndikon në sigurimin e ujit të pijshëm, për vaditje, për rezerva ujore, për sigurimin e energjisë elektrike, për zhvillimin e turizmit, të peshkimit, të transportit detar, të sporteve ekstreme, etj.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Pasuria ujore ndikon në zbutjen e klimës dhe krijon mjedise të rëndësishme për botën e gjallë.” Për çfarë pasurish ujore, dallohet vendbanimi yt?<br>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë mbi pasurinë ujore të Shqipërisë (nga emisione të ndryshme televizive, nga media, revista etj),dhe të vendbanimit të tyre.<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesja fton nxënësit/et të lexojnë informacionin që ofron teksti mbi hidrografinë e Shqipërisë dhe të shohin me vëmendje hartën e Shqipërisë të ekspozuar në klasë dhe hartën e figurës 2.<br>Diskuton me ta mbi informacionin e dhënë.<br>Më pas mësuesi/ja u jep nxënësve me shënime (të printuara) të dhëna mbi tiparet e hidrografisë së vendbanimit të tyre.<br>Bazuar në to, nxënësit diskutojnë, krahasojnë, vlerësojnë pasurinë ujore...<br>Më pas orientohen nxënësit të punojnë me ushtrimin 1 dhe të diskutojnë mbi të.<br>**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Orientohen nxënësit të hulumtojnë, vëzhgojnë dhe të prezantojnë mbi vendbanimin e tyre.<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup. Plotësohen kërkesat 2a/b të rubrikës “Radha jote” dhe nxënësit/et dhe të diskutojnë mbi to.<br>Lihet detyrë në shtëpi: ushtrimin 3 nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 3.4 Klima dhe bota e gjallë në vendbanimin tonë

| **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI** | **LËNDA: GJEOGRAFI** | **SHKALLA: III** | **KLASA: VI** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal** | | **Tema mësimore: 3.4 Klima dhe bota e gjallë në vendbanimin tonë** | |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**<br>**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**<br>• Përshkruan qartë dhe saktë, tiparet e klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj.<br>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tipareve të klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime. | | | |

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Interpreton në hartë, hulumton dhe ndërton indormacionin e duhur (duke e ilustruar me shembuj konkretë) mbi tiparet e klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti, mësuesja internet, media, për të nxënë.
- Ndërlidh temën e re me njohuritë, përvojat paraprake, informacionet e dhëna nga mësuesja, të marra nga pushteti vendor apo gjatë hulumtimeve e vëzhgimeve, mbi tiparet e e klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti /hulumtimi në bazë grupi).

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Tregon vetëbesim të lartë në përfundimet e nxjerra prej tij dhe kontribuon përmes tyre në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja hulumton e vëzhgon përbërësit kryesorë të klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja përcjell informacion midis anëtarëve të grupit mbi veçoritë kryesorë të klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tij/saj.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja përcakton dhe vlerëson tiparet kryesorë të klimës dhe të botës së gjallë së vendbanimit të tij në favor të jetës dhe të zhvillimit ekonomik të zonës.

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja përshkruan mikroklimën dhe botën e gjallë në mjedisin ku jeton. | **Fjalët kyçe:** mikroklimë, botë bimore dhe shtazore. |
| **Burimet:** Teksti, harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë (e ekspozuar në klasë dhe e siguruar nga interneti - e të printuar), pamje të ndryshme që tregojnë për mikroklimën dhe botën e gjallë të mjedisin ku nxënësi/ja jeton. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, matematikë, biologji. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve**

| | |
|---|---|
| ***a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** | Nxënësit/et dinë:<br>a. Informacione të ndryshme mbi klimën dhe botën e gjallë në Shqipëri dhe në vendbanimin e tyre. |
| ***b. Ndërtimi i njohurive të reja*** | **Situata e të vepruarit**<br>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj) dhe të dhënat që jepen për Shqipërinë.<br>**Veprimet në situatë**<br>**Hapi I : Rrjeti i diskutimit**<br>Mësuesi/ja ekspozon në klasë hartën e Shqipërisë dhe fton nxënësit/et të diskutojnë mbi situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.4 (në tekst) – "Diskutojmë: Klima e vendit tonë, në perëndim është mesdhetare me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Më në lindje të vendit, ajo bëhet më kontinentale me dimër më të ashpër (edhe me reshje bore) dhe me verë më të freskët. Në lartësitë e maleve klima është malore. Përshkruaj edhe ti tiparet e klimës së vendbanimit tënd."<br>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë, mbi bazën e atyre njohurive që kanë mbi klimën dhe botën e gjallë në Shqipërisë (nga emisione të ndryshme televizive, nga media, revista etj) dhe të vendbanimit të tyre.<br>**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**<br>Mësuesja fton nxënësit/et të lexojnë informacionin që ofron teksti mbi klimën dhe botën e gjallë në Shqipërisë.<br>Diskuton me ta mbi informacionin e dhënë.<br>Më pas mësuesi/ja u jep nxënësve me shënime (të printuara) të dhëna mbi tiparet e klimës dhe të botës së gjallë në vendbanimin e tyre.<br>Bazuar në to, nxënësit/et diskutojnë, krahasojnë, vlerësojnë klimën dhe botën e gjallë....<br>Më pas orientohen nxënësit të punojnë me ushtrimin 1 dhe të diskutojnë mbi të.<br>**Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup**<br>Orientohen nxënësit të hulumtojnë, vëzhgojnë dhe të prezantojnë mbi vendbanimin e tyre.<br>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup. Plotësohet rubrika "Radha jote" dhe nxënësit të diskutojnë mbi to.<br>Lihet detyrë në shtëpi: ushtrime nga fletorja e punës. |
| ***Prezantimi dhe demostrimi i rezultateve të arritura*** | Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** | Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup. |

# Tema mësimore: 3.5 Popullsia në vendbanimin tonë

| FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI | LËNDA: GJEOGRAFI | SHKALLA: III | KLASA: VI |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika III: Mjedisi ynë lokal** | | **Tema mësimore: 3.5 Popullsia në vendbanimin tonë** | |

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth popullsisë së vendbanimit,duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Veçon informacionin kryesor nga botimet e INSTAT, gazeta, revista, internet, radio, TV etj., i komenton dhe i shfrytëzon atë si referencë gjatë hulumtimit, vëzhgimit dhe prezantimit të vendbanimit.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Parashtron argumente pro ose kundër mbi faktorët që kanë ndikuar në lëvizjen migratore të popullsisë brenda dhe jashtë vendit.
- Interpreton faktet e sjella duke ilustruar me shembuj konkretë.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (INSTAT, gazeta, revista, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon gjatë hulumtimit, vëzhgimit dhe prezantimit të vendbanimit.
- Shfrytëzon të dhënat e marra nga burime të ndryshme, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat sipas një radhitjeje logjike.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktivitet i(në klasë/shkollë apo në terren).

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)***

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)***

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)**

- Tregon vetëbesim të lartë në përfundimet e arritura prej tij/saj dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së përfundimeve të grupit /klasës.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë diversitet kulturor, etnik, fetar,gjinor etj, në shkollë apo në komunitet.

**7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)***

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

<table>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës<br>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike<br>Nxënësi/ja hulumton dhe vëzhgon mbi numrin, strukturën (moshore dhe gjinore) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë në vendbanimin e tij/saj.<br>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit<br>Nxënësi/ja përcjell informacion midis anëtarëve të grupit mbi numrin, strukturën (moshore dhe gjinore) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë në vendbanimin e tij/saj.<br>3. Marrja e vendimeve<br>Nxënësi analizon faktorët që kanë ndikuar mbi numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë në vendbanimin e tij/saj.</td></tr>
